

Poetja dhe skenaristja Natasha Lako në një bilanc artistik se si lexohet sot gjithë krijimtaria e saj në poezi dhe kinematografi; nga poezitë e para në vitin '72, me shenja rebelizmi nisur nga dashuria dhe misteret e nënvetëdijes femërore në rrethanat e një shoqërie totalitariste

NATASHA LAKO PROZA KA LINDUR PREJ GRAVE, CA SHTËPIAKEVE PLOT NGJARJE APO ËNDRRA DASHURORE

Skenaristja flet për njohjen me regjisorin Mevlan Shanaj dhe jetën së bashku edhe në kinematografi duke shënuar nga produksionet filmike më të debatuar për diktatin ideologjik dhe censurën; cili është qëndrimi i Lakos sot për kinemanë e ish-Kinostudios?!



(Fq. 2)

OPINION

NATA E VARRIT DHE NJERIU POLITIK

Nga Nebi Bardhoshi

(fq. 7)



FRYMËZIME DJALOSHARE

Nga Hyjni Ceka

Kadarenë e kam shok prej vitesh... Jemi pjekur, së pari, ndën shkallë të gjimnazit Asim Zeneli", në Gjirokastrë. Isha emëruar mësues në Lunxhëri. Ismaili... po... gjimnazist, në vit të dytë...

(vijon në fq. 6)

MUZIKA



MIKAELA MINGA, CD-JA UNIKE ME KËNGË ARUMUNE, JETA NOMADE E BREZIT TË FUNDIT

Nga Suadela Balliu

KRITIKË

Anna Akhmatova, fati i poetes edhe në përtëjvarr

Nga Agron Tufa

(Fq. 10)

Historia e vajzave dhe virgjërshave të Ridvan Dibrës

Nga Andreas Dushi

(Fq. 5)

Shpjegimi e cënon thelbin

Nga Edison Çeraj

(Fq. 11)




VEDAT KOKONA ME DISHEPUJT E VOLTERIT

BIBLIOTEKË


SHQIPTAR OSEKU

POEZITË E MËRGIMIT



MARGARET LAURENCE PORTRETET E PAHARRUESHME TË GRAVE KUNDËR DEMONËVE TË TYRE

(Fq. 14)



Poetja dhe skenaristja Natasha Lako në një bilanc artistik se si lexohet sot gjithë krijimtaria e saj në poezi dhe kinematografi; nga poezitë e para në vitin '72, me shenja rebelizmi nisur nga dashuria dhe misteret e nënvetëdijes femërore në rrethanat e një shoqërie totalitariste

NATASHA LAKO


PROZA KA LINDUR PREJ GRAVE, CA SHTËPIAKEVE PLOT NGJARJE APO ËNDRRA DASHURORE

Skenaristja flet për njohjen me regjisorin Mevlan Shanaj dhe jetën së bashku edhe në kinematografi duke shënuar nga produksionet filmike më të debatuar për diktatin ideologjik dhe censurën; cili është qëndrimi i Lakos sot për kinemanë e ish-Kinostudios?!

Bisedoi: Violeta Murati

Biseda me ju është gjithnjë një kompleks ngjarësh, që më ngjan se kështu keni jetuar gjithnjë e lirë, në mënyrën se si keni ndërtuar jetën tuaj artistike në film, poezi apo angazhime sociale... Ju vazhdoni të shkruani duke thyer përherë tabu, si në vitet e regjimit komunist edhe tani. Çfarë ka qenë kjo rezistencë, liri, për ju?

Varet si e percepton lirinë. Ne po e fillojmë këtë bisedë në një kafe të Tiranës, ku ka nisur filli i poezisë që e dua mjaft dhe që quhet: “Dy palë atlete dhe dy palë çizme të njëjta.”



Liria mund të vërtitet edhe rreth e rrotull kafeneve, por atje, brenda kësaj poezie, liria e vetme është ajo që e bën njeriun të lidhet me të gjitha kohërat. Gati automatikisht.

Më pëlqen të citoj edhe një poezi tjetër, *Pylli*... Po ta mendosh thellë-thellë, ai është një pyll imagjinar, sepse shqiptarët i kanë prerë pyjet. Ai duket sikur shfaqet që nga vajzëria e parë deri sot, kur fjala *grua* merr kuptimin e pjekurisë. Por unë i lejoj vetes lirinë e perceptimit të pyllit si forcë mashkullore. Vargu i fundit i kësaj poezie është: *Pikonte rrëshirë*. Jam çuditur edhe vetë, rastësisht më pas, kur kam zbuluar se rrëshira që nga kohët antike simbolizonte gjithë virilitetin mashkullor. Liria ime në këtë rast lidhet me traditën mijërvjeçare. Kjo mund të jetë edhe një lloj robërie tjetër.

Sigurisht, ky lloj diskutimi na lejohet, meqë e gjithë kjo bisedë do të hidhet në gjuhën e shkruar. Në raste të tjera mund të mungojë krejt liria e jashtme, por poezia vetë krijon lirinë e vet. Kjo ngandonjëherë më ka bërë të lumtur, vetëm kur në një poezi të shumë viteve të shkuara ka mbetur vargu “më mirë një gënjeshtër më pak!”

Gjithçka është vërtet shumë e komplikuar, por çdo njeri ka mundësi të gjejë rrugën e vet, që më tepër për mua ka qenë një imitim lirie. Ku një rol të madh ka luajtur leximi.

Libri i parë në '72-in dhe i fundit, “Kundërpërfytyrimi”, në fund të 2016-ës, për të cilin rrallë ndodh që kritika të reagojë në kohë reale duke e konsideruar ngjarje për poezinë bashkëkohore; një libër shqetësues që “nuk sjell hare dhe paqe...”, që e detyroni ju të thotë: “Tani ka ardhur, siç duket, radha e stocizmit tim.” Kujtesa dhe historia që mbajnë këto dy segmente, besojmë kanë pasur një shtysë, nxitje.

Ta lëmë mënjatë lirinë e madhe që sjellin veglat e prodhimit, ku Shqipëria nuk është përfshirë ende. Që nga koha e parmendës, që jo më kot insiston të mbijetojë

në shoqëritë fisnore, e deri sot, Shqipëria mbetet një prodhim kulturor. Prandaj më pëlqen të ripërsëris, si klasifikime, tri etapa të mëdha kulturore ku edhe shqiptarët bëhen pjesë e civilizimeve: atë të papiruseve që u takonte vetëm dinjitarëve, pa gjurmë për ne, mungesa e të cilave na mundon; atë të shtypshkronjave dhe demokratizimit që vjen pas marrjes gjerësisht të librit në duar, por që ka qenë nën represion deri në fund të viteve '80 në Shqipëri, më gjatë se kudo; dhe tashmë, epokën e sapofilluar, ku milleniarët e rinj, jo pak, por sot 20-vjeçarë që i takojnë plotësisht një kohe tjetër të informacionit. Në gjuhën popullore ne, të tjerët, sapo kemi ngjyer gishtin në këtë mjaltë të ri. Këta milleniarë, njësoj si brezi im i pasluftës dje, kanë jetuar vetëm me jehonat e tërmeteve plot amplituda ballkanike. Dhe, për çudi, në të njëjtat amplituda me qëndrimin shekullor ndaj femrës – femra njësoj si ndaj librit, – të çliruar shumë vonë.

Dhe kësaj pasqyre sinoptike shoqërore mund t'i shtojmë intrigën, të vetmin prodhim shoqëror që në Shqipëri sjell mjaft rezultate.

Në poezinë *Dhelpra B*, të mesit të viteve '90, unë e shpreh këtë gjendje përplasjes dhe kulture intrige që në Ballkan nuk ka të sosur dhe ku ka rëndësi më tepër ajo çka krijohet në mendje sesa një realitet i caktuar. Në këtë poezi vrasja ekziston si mundësi dhe si imagjinatë. Mos harrojmë se më vonë, te *Kundërpërfytyrimi*, jemi pranë vitit 2019.

Unë mendoj se përplasjet e fundit politike që po shohim, janë bishti i fundit i një komete të dendësuar nga ngjarje më të përshpejtuara se asnjëherë tjetër. Të injorosh këtë imagjinatë dhe këtë realitet është e pamundur. Kështu që poezia, ndoshta edhe e imja, duket sikur jeton në ndonjë planet tjetër, sepse e ka kapërcyer këtë periudhë. E ka braktisur këtë tokë të ngopur me riciklime. Besoj se do ta kapërcejë këtë periudhë gjithë Ballkani, ku të gjithë sillen si fëmijë që po i mësojnë të vërtetat sot. Të gjithë këto e bëjnë poezinë më të rafinuar. Por jo pa një adresim.



Jeni shprehur se *Ditari* i Ana Frankut ishte një tronditje e madhe për ju, prej të cilit kujtoni se keni shkruar një nga poezitë e para, botuar në '64-ën... Ç'ishte ky ndikim, pothuaj zbulim i pazakontë për kohën? Ju pothuaj gjithnjë keni folur për gratë që kanë lënë gjurmë te ju, por sot është e vështirë...

Ditari i Ana Frankut ka një forcë të madhe jete. Sidomos për një vajzë në kohën e pubertetit si unë dhe zbulimin e erotizmit të shprehur si për vete. Kam qenë në moshën e saj kur e kam lexuar atë jetë të kondensuar në pak vite. Ky libër ka brenda tij shumë dritë, me një *këmbishë* vajze brenda.

Dhe, më pas, kanë ardhur autore të tjera. Unë tani jam në momente që e di se do të mbeten shumë shkrimtare gra të panjohura, sa do të përpiqem që t'i gjej. Dhe më duket se kam borxh t'i kujtoj edhe ato në përumbësi... Romani europian, siç veçon kritika, fillesat e veta i ka në novelat sentimentale të grave. Proza ka lindur prej grave, ca shtëpiakeve plot ngjarje dashurore ose ëndrra dashurore. Është bukur të thuhet. Dhe të gjitha gjysmë anonime. Është pothuaj një i tillë gjysmë anonimiteti që vlon sot në postimet elektronike. Është një forcë e thellë, e padukshme shumë herë.

Janë bërë emblema disa vargje të tuat, një poezi mjaft e herët: 30 qindarka për të ardhur tek ti dashuri/ 20 qindarka për të folur me ty... etj., vargje rebele, bërë hit. Çfarë momenti ishte për ju kur u shkrua kjo poezi?

Mund të konsiderohet si një pamflet, derisa ju po e quani poezi rebele. Ka qenë një moment prove. Kam pyetur thjesht veten se si mund të shkruaja një poezi dashurie. Përbetim, pafajësi, varfëri, aventurë, merreni si të doni. Sidomos kur vargu "50 qindarka për të bërë dashuri" u vendos përsëri, pasi ishte redaktuar, mund të lejojë edhe diskutime të tjera të hapura. Më ka thënë

Moikom Zeqo se e ruan këtë dorëshkrimin.

Aq sa duket se unë kam filluar të botoj që në kohën e papiruseve. I dërgoja poezitë në gazetën "Drita", me shkrim dore.

Dua të ndalem në këtë moment pasi pjesë e historisë së jetës suaj, por edhe në kinema, është regjisori Mevlan Shanaj, me të cilin keni ndarë së bashku jetën. Si jeni njohur?

Jemi njohur në saxe të këmbënguljes së Mevlanit, që gjente gjithnjë rastin si të shiheshim gjoja rastësisht. Ajo që më ka pëlqyer nga ato takime të para, ka qenë se ai nuk kishte fare dijeni se unë shkruaja. Dhe them se pëlqimi fizik është gjëja më esenciale në një çift. E dyta, verifikimi që kishte të bënte me lirinë shprehëse.

Bashkudhëtar në historinë e kinematografisë (shumicën e prodhimeve filmike i keni së bashku), a mund të na kujtoni kur ka qenë më delikate jeta apo puna së bashku, po flas për diktaturën, si ia keni dalë censurës? Nëse ka ndodhur përvojë e tillë, çfarë ishte shmangie...

Ka ndodhur. Që suksesi i filmit *Mësonjëtorja*, me regji të Muharrem Fejzos, të mbrojë në njëfarë mënyre vëllimin tim *E para fjalë e botës*, të botuar në kulmin e terrorit të mesit të viteve '70. Sigurisht, me Mevlanin diskutimet për të marrë përsipër ndonjë temë më domethënëse ishin krejt të hapura. Në Kinostudio unë i çoja *faite a complie*, si fakte të kryera. Kjo arrihej sa herë respektoje lirinë e brendshme dhe terren mund të gjeje, duke nuhatur çfarë teme mund të pranohej ose jo. Mund të them madje se, sado që mund të ketë pasur edhe tema të porositura, këto kishin lidhje me vullnete të brendshme.

Sepse ka dallim mes lirisë së brendshme dhe vullnetit të brendshëm. Por mendoj se në jetën e përditshme diktatura i bënte të gjitha më hipokrite

se sa ishte edhe vepra filmike më e angazhuar. As që mund të bëhej fjalë që atë që nuk e thoshe në një bisedë të përditshme, të shkoje pastaj ta artikuloje në një film. Kjo më bëri që unë të përzgjedh në shumicën e rasteve temat historike.

Pra, angazhim i një natyre jo aq lirike sa poezitë u bë edhe kinemaja, ku indoktrinimi s'përkonte, siç shohim, me mundimet e tua, ku as mund të flitej për "pavarësi intelektuale"...

Unë kisha lindur në një qytet që filmin e kishte pjesë të jetës. Në kushtet shqiptare ishte si të thuash të kishe kaluar që në fëmijëri një shkollë filmi. Tradita e Korçës ka qenë të bëhej një qendër arti. Kjo e shpjegon pak a shumë edhe barsoletën se Kinostudioja ishte e mbushur me korçarë. Dhe mendoj se, kur ekrani të trondit, bëhet pjesë dashurie. Por ishte Mevlani që më orientoi drejt Kinostudios. Poezia vetëm më ndihmoi me imazhin e saj. Në atë periudhë është shkruar poezia *Urdhër pune i klasës së tretë*, kushtuar Shtjefën Gjeçovit. E mbaj mend që e mësova lajmin e dekorimit të tij nga televizori, në të njëjtën ditë kur mua më patën njoftuar se mund të punoja vetëm në ndërmarrje të kategorisë së tretë. Që të shpjegosh përse, kur gjithë populli e konsideronte kinostudion si të vënë në *top listë*, për këtë madje është vënë nën akuzë, më pastaj të kuptosh përse për pushtetin ishte si vera e kategorisë së tretë, – për këto rrethana nevojitet ndonjë shkrim më vete. Ka rëndësi që kjo periudhë totalitariste të analizohet jo në mënyrë totalitariste *en bloc* sepse jeta nuk shter dot.

Nuk e mendoj kinemanë si indoktrinim të plotë. Kjo është e pamundur. Aq më tepër se imazhi e tradhton çdo gënjeshtër. Në poezi unë jam detyruar të krijoj edhe vargje skeletike, për të mbajtur një vëllim më këmbë. Ndërsa pavarësia intelektuale vështirë se arrihet në shoqëritë e mbyllura. Qoftë deri sot.

Mevlani si regjisor e ju si skenariste, pjesën dërrmuese të krijimtarisë e keni nga kinemaja e diktaturës, filma që kanë pasur "suksesin" e kohës, si *Mësonjëtorja*, *Plumba Perandorit*, *I teti në Bronx*, *Fletë të bardha*... Shumë debate deri tani janë bërë për pranimin dhe shfaqjen normale të kësaj prodhimtarie. Ju çfarë mendoni, a keni ndier nevojën e një qëndrimi në distancë për të kuptuar si ka funksionuar nënvetëdija juaj?

Që pjesën dërrmuese të krijimtarisë kinematografike, si unë edhe Mevlani, e kemi nga koha e diktaturës, është faji i shoqërisë shqiptare që nuk ka mundur të ruajë njëfarë ritmi të prodhimit të filmit, pasi vetëm kjo e mban edhe spektatorin gjallë. Edhe njëherë kur i përmendni ju, unë kujtohem të them se vërtet temat e filmave tanë japin disa herë afreske hap pas hapi të jetës shqiptare, që nga rilindja, vitet '20, vitet '30 që sjellin një fytyrë tjetër, vitet '40 po me përkthyerje të mëdha, diçka nga vitet '80, '90 po e po, për t'u kthyer në krijimtarinë time edhe në legjenda.

Rileximet vijnë vetvetiu, por kjo arrihet vetëm nga studiues serioze. Ndërsa nënvetëdija vepron çdo çast. Sepse nuk ka vepër ku krijuesi të mos përcjellë pjesë të vetes. Pa përjetuar paradat e jetës shqiptare, nuk mund të realizoheshin ato të ardhjes së Viktor Emanuelit në Tiranë, në filmin *Plumba perandorit*, fjala vjen.

Kjo ka ndodhur edhe me filmat pas '90-ës. Në rast se ju kujtohet finalja e filmit *Lule të kuqe lule të zeza*, një finale aq e evidencuar edhe me "Frame" kopertinë në një studim botëror mbi kinematografinë e vendeve të Europës Lindore, përfshi edhe Rusinë e sotme, imazhi i një çifti të lidhur, si të detyruar për të qenë bashkë në këtë vend dhe për të pasur të njëjtin fat – ky ka qenë shumë i fuqishëm. Është shumë shprehës dhe është kuptuar aq thellë. Kaq mund të bëjmë ne. Është detyrë e kritikëve të zbulojnë edhe ato që mund të rizbulohen nga leximet e filmave të djeshëm. Vetëm një shoqërie përtace këto nuk kanë përse t'i duhen, qoftë

për të kuptuar edhe atë periudhë, por edhe vlerësime të përkohshme ose utilitare do të ketë gjithashtu.

Filmi *Fletë të bardha*, pothuaj i realizuar në fund të rënies së sistemit. Para pak kohësh në media pothuaj u spekulua mbi telefonatën që keni marrë nga Nexhmie Hoxha për këtë produksion. Si qëndron e vërteta, a duhet që ju që na keni lënë këtë trashëgimi, të na flisni me sineritet për atë, pa alibinë se “ashtu ishte koha” dhe se ishte “budallallëk të kundërshtojë”?

Në këtë film ka kundërshtim të hapur. Dhe teza që shtrihen për herë të parë, si ngulmimi për pronën private, ose për skleroartin. Shoqëria ishte përgatitur t’i thoshte hapur të gjitha këto. Vetë unë kam pasqyruar edhe krizën e statukuosë sime, sepse në qendër është një shkrimtar. Ky film pati debate të forta, njerëz që të godisnin fort dhe njerëz që përkrahnin, ashtu si ndodhi edhe me ngjarjet e 2 korrikut. Sepse filmi për herë të parë u shfaq në maj të vitit ’90, ndërsa pas 2 korrikut askush nuk mund ta kishte më mendjen te një film që u shfaq vetëm dy muaj më përpara. Mbaj mend se nuk pushonte telefoni. Dhe pastaj ai zëri karakteristik, një ditë të premte, që na lajmëronte edhe për botimin e një shkrimi që do të dilte të hënën, aq e saktë kishte qenë porosia, siç ndodhi vërtet. Por, sot, askush nuk mund të kuptojë më çdo të thoshte një *exkomunikim* në gazetë. Mendoj se, sot, për të tjerët këto mbeten vetëm kuriozitete. “Kolaboracionistëve” të asaj kohe ky film nuk u intereson sepse nuk e gjejnë veten. Ky film, së bashku me vëllimin poetik *Natyrë e qetë*, shënon pjekurinë e krijimtarisë sime.

A keni pasur koshiençë për filmat tuaj, si sot mund t’i lexojnë mesazhet e tyre?

Temat e filmave të mi e kanë pothuaj gjithnjë represionin.

Me filmin merret edhe djali juaj Joni, që krijoi një individualitet të vetin pothuaj menjëherë, me pritjen e filmit “Farmakon”... Pse ndonjëherë prindërit bëhen kaq “fanatikë” të trashëgimisë së “zanatit”? Çfarë besoni te Joni, a ka diçka që nuk është realizuar te ju dhe Mevlani?

Farmakon ka arritur në YouTube dhe Vimeo pothuaj 2.000.000 shikues. Ndërsa ka edhe disa kritikë ndër njohësit më të mirë të prodhimit të sotëm botëror që e



kanë quajtur kryevepër. Nuk kam ç’të them më tepër. Vetëm se ai film më ka ndihmuar ta njoh shumë më tepër djalin tim. Sa për atë, që i biri i një kineastit, zgjedh profesionin e kineastit, unë mendoj se kjo është diçka për t’u gëzuar më tepër.

Ju e njihni, jo vetëm filmin, por edhe gjithë “pasurinë” arkivore si ish-drejtuese e Arkivit të Filmit. Botuat librin *Energjia filmike*, një kontribut mjaft i rëndësishëm për këtë histori, por keni bërë edhe një panoramë mbi filmat e realizmit socialist, referuar festivaleve, se çfarë përfaqësonin ato për regjimin. Pse e keni ndërprerë këtë proces kërkues, por njëkohësisht edhe orientim, ashtu siç edhe historia ka nevojë të rishihet?

Ishte përgjegjësia ime për të lënë të shkruar këndvështrimin tim për kinematografinë shqiptare.

Ju shpesh i mëshoni faktit mbi angazhimin femëror kudo, por në veçanti edhe dyndjes së tyre në poezi. Shumë poete nuk e duan këtë klasifikim, për ju pse krijohet ky dallim mbi “zërin femëror”?

Besoj se ky zë femëror vjen vetvetiu. Vëreni po të doni vargjet e mia; të thjeshta, të mbushura me qindarka të vogla nën një emër mashkullor. Është e pamundur.

Besojmë se nuk ka qenë e lehtë rruga juaj për të qenë një autore e konfirmuar. Duke kujtuar se si në vitin 1848 Sharlote Bronte edhe Emili Bronte zbulojnë njëra-tjetrën me emra mashkullorë – thoni diku se nëse duhet të bëje spekulacione të thella dhe të kishte logjikë, të vërtetë, duhet të kaloje nga ana e burrave... A e pranoni vërtet, pse është e vështirë për të bërë letërsi një grua?

Po, shpeshherë edhe detyrohesh të kalosh në anën e burrave. E ka bërë Koleta në vitin 1920, kur të gjithë e quanin Parisin kryeqytetin e botës. I ka botuar romanet me emrin e bashkëshortit, madje ka parë lavdinë e tij. Kjo është bërë edhe për të mohuar veten, herë për ta pohuar atë. Por gjithashtu kjo tregon shfrytëzimin e madh që zbret deri në shkallët e trafikimit të trupit të femrës, ku të rinjtë shqiptarë janë bërë të famshëm në Europë. Sepse gjithnjë janë shfrytëzime të sofistikuar, ashtu si edhe brutale. Për maskilistët, gjithnjë si shfrytëzues, por të ndershëm, detyra më e madhe

shoqërore e gruas kur del jashtë shtëpisë është që, me bukurinë e feminitetit të saj, të mbulojë nëpër revista dhe blogje gjithë brutalitetet e tjera. Ndoshta edhe ky është një mjet shërues. Po ta keni vënë re, buçasin kohët e fundit vargje të poetëve shqiptarë maskilistë, të mbushura me adhurime pleqsh për ca vajza të cilave sa u ka shpërthyer gjiri. Dhe këta janë ata më fisnikët! Merreni me mend ta bënte këtë Bodleri, ose Eliot, ose Ungareti, ose Neruda, të cilët humanizmin e thellë e kanë të parin. Madje Bodleri poezitë më të bukura i ka për gjinjtë e shfrytëzuar keq.

Kjo modë maskiliste jashtëzakonisht shqiptare, edhe poezinë femërore, e ndan në vargje si kuadrate të veçanta haremesh. Në këtë kuptim, duhet të jesh pak edhe Lasgush, edhe Arap, që të bashkohesh me poezinë e vërtetë. Dhe në ndonjë rast, siç ka përkrahur një shkrimtare e gjuhës ruse që ka marrë çmimin Nobel, që të mbrosh botën tënde, detyrohesh të veshesh edhe kapotën e ushtarit, megjithëse lufta e shfityron si feminitetin edhe gjithë jetën dhe instinktet e saj. E kam nisur leximin e librit me intervista grash të kësaj shkrimtareje, me frikën se mos binte në komente të sotme të gazetarisë dhe opinionit shqiptar që ka filluar të tallet me vajzat shqiptare që dolën partizane. Por, përkundrazi, kam parë gjithë shkëlqimin njerëzor dhe një marrëdhënie të thellë humane që, natyrisht, i dha edhe Nobelin. Betejë apo jo? Dhe ekuilibër që në shoqërinë shqiptare, me shkëlqimin e Tiranës si të Parisit të viteve ’20, nuk është vendosur ende. Dhe ky shkakton një prodhim vuajtjesh të dyfishta, edhe për gjininë femërore, ku ato marrin formën më biologjike, edhe për gjininë mashkullore të një shoqërizimi më të lartë. Por nuk mund të këtë shoqëri më reaksionare se kjo.


Në një forum mbi letërsinë shqipe sot keni thënë se “jemi në krizë dhe na vjen pyetja se pse nuk e shprehim më veten ashtu siç jemi”... Pse ky fenomen, është pyetja edhe për ju?

E kam thënë edhe njëherë tjetër se letërsia e sotme shqipe nuk ka si të mos pasurohet me vepra të reja të arrira. Por ajo e ka të vështirë të sjellë personazhet e plotë, përfaqësues të vetes. Shumica e veprave të sotme mishërojnë këtë periudhë të shpërndarë copë-copë, por jo të individit të sotëm. Por edhe kjo tregon shumë. Madje çdo individ është si kolazh i periudhave të ndryshme. Nuk i mungon as pelerina ilire.



NGA IRENA TE MADALENA, HISTORIA E VAJZAVE DHE VIRGJËRESHAVE TË RIDVAN DIBRËS

Nga Andreas Dushi



Ishte viti 1993 kur ndër radhët e intelektualëve shkodranë u shpërnda me të shpejtë, herë mbi dorë e herë nën të, një libër i vogël me titull, për kohën, mjaft provokues. “Prostituta e Virgjër” erdhi si një burim vlere mes shkretëtirës së letërsisë që, duke u çliruar nga kufijtë e vendosur prej diktaturës komuniste, nxori në dritë vepra, vlera e të cilave ishte vetëm kostoja e letrës së harxhuar për to.

Në të, autori kërkon të përshkruajë Irena B., vajzën e qytetit të tij, nëpërmjet syve të “atij”, personazhit i cili jo domosdoshmërisht personifikohet me vetë autorin. Motivi i një prostitute të virgjër erdhi ndër letrat shqipe si zëri i parë kritik karshi pjesës moraliste të letërsisë së realizmit socialist.

Vetë termi “realizëm socialist” nuk shpreh asgjë, për sa kohë që letërsia e cila përfaqësonte këtë rrymë, tregonte për jetesën e frytshme gjatë socializmit, i binte ndesh realizmit, pasi jetesa e frytshme vetëm reale nuk ishte. Edhe personazhet të cilët ndaheshin me hendek njëri prej tjetrit, i pari pozitiv (i bardhë) dhe i dyti negativ (i zi), nuk përfaqësonin asgjë që mund të ishte reale.

Por për të mos u ndalur këtu, pasi këtë temë ndoshta do të lexoni ndonjë herë tjetër, le t’u rikthehemi sërish virgjërshave të Ridvan Dibrës. Libri i tij i

fundit, botuar nga “Onufri”, mban titullin “Dashuritë e virgjërshës Madalenë”, për të cilën virgjëria ishte problem kur ishte dhe kur nuk ishte. Në të trajtohen problemet një vajze në raport me shoqërinë dhe të shoqërisë karshi saj.

Në kontekstin biblik, fiku është fruta e vetëmjaftueshmërisë dhe Madalena duket sikur e ka këtë frutë të preferuarën e saj. Përkundër dashurive të pakta dhe të pavlera, vetëmjaftueshmëria është për Madalenën çelësi praktik që zgjidh çdo problem patetik. Ndryshe nga sa shfaqet zakonisht në letërsinë e Dibrës, Madalena nuk jepet nga optika e një burri që u druhet grave e vajzave, por nga subkoshienca e një gruaje që i druhet koshiencës së saj.

Nga Irena deri te Madalena, pena e shkrimtarit Dibra ka flirtuar me shumë vajza e gra, duke çelur gjithnjë një shteg nëpër të cilin kalojnë emocionet, ndjenjat dhe epsheet e personazheve djem e burra. Pas “Prostitutës”, do të ishte romani “Nudo” ai që me subjektin e tij do të krijonte një hendek të madh mes letërsisë si art dhe letërsisë si dëshirë për t’u shprehur. Në këtë roman, dy sy vocërrakë shfaqin epsh për një mijë vajza. Në filtrin e faktorëve të jashtëm nëpër të cilin epshi kthehet në pushtim, vetëm njëri syresh kalon.

Në një vit në krye të një konvikti, plani fillestar i pushtimit të madh që Alfred Boka bën, kthehet në një pushtim papërfillshmërisht të vogël e kështu, në vend të të tjerëve, Boka push[t]on vetveten.

Rasti i “Nudo” paraqet burrin ëndërrimtar e njëherazi deficiënt përballë vajzave të reja me synime të singerta që deficienca mashkullore i kamuflon në manifestime të ëndrrave që pjell vetë.

Shpesh, sikurse edhe në romanin e fundit, Dibra përfshihet vetë si personazh duke vënë përballë vetes ngjarje të stisura apo reale. Kështu ndodh me tregimin “Unë, Franc Kafka dhe Karta e Bolonjës”, pjesë e librit me të njëjtin titull. Aty personazhi Ridvan Dibra përballlet me një kolege të re, doktore shkencash, e cila njëkohësisht ishte “alamat femre”. Kur personazhi i flet personazhes për Kafkën, personazhja i flet atij për Kartën e Bolonjës e kështu, si dy kolegë, të ngjashëm në profesion dhe rrjedhimisht, edhe në shijen e bisedave, ata ndahen të kuptuar aq mirë sa *bë për bë, për një kafë të dytë, as që mund të mendohej*.

Kur Dibra rreket të kërkojë në të shkuarën fëmijën e humbur me dëshirën për ta sjellë në të tashmen, shohim se si personazhi dhe vajzat pleksen herë pas here, por gjithnjë në mënyrë platonike. Falë vogëlsisë moshore e ndoshta edhe trupore, personazhi i librit gjithnjë kompleksohet para në vajze, ndihet inferior dhe mendon se asnjëherë nuk do ia dalë me to. Sikurse të gjithë në një moshë të hershme, me shokët e tij i sheh

fshehtas në banjat e shkollës. Zotëron të gjithë sekretet femërore të atyre vajzave dhe pavarësisht kësaj, nëpër shkallë e korridore nuk u flet. Duket sikur ka frikë nga diçka, por nga çfarë, për sa kohë njeh sekretin e tyre më të madh?

Figura e vajzës këtu jepet në mënyrë tangjente, duke e prekur realitetin mashkullor të djalit vetëm në një pikë, atë të gjenezës së epsheve, por pa vijuar më tej, pasi bëhet fjalë për moshën rreth së cilës djemtë i shohin vajzat si “armike”.

Me librin “Kanuni i Lekës së Vogël”, Dibra sqaron pozicionin e vajzës dhe të gruas në familje, shoqëri dhe punë. Duke qenë se ky kanun ka vlerë juridike në Egobokë, vendin ku gjallojnë shumica e personazheve të tij, autori tregon se çfarë letërsia e tij quan të ligjshme dhe çfarë jo. Nderi, pastërtia dhe virgjëria e vajzës, ndonëse duket sikur është në dorë të burrit, në të vërtetë, është në dorë të saj dhe ajo është aq e zonja, sa ia del të bëjë të duket sikur nuk është kështu. Në këtë skutë që ajo krijon, gjen follenë e vet vuajtja që ngjall feminizmin e të tjera gjëra për të cilat gjithashtu, nëse do të flasim ndonjëherë për Simone de Beauvoir, do i trajtojmë.

“Legjenda e vetmisë”, libri i njohur i Dibrës, përkthyer në frëngjisht dhe së fundi kandidat për çmimin ballkanik të letërsisë, e jep gruan si atë që “t’birin ka qorrue, me gjaks t’burrit me u martue” dhe vajzën në funksion të mashtrimit të përgjithshëm familjar. Personazhi, i pamësuar me elokuencën e fjalëve dhe lëvizjeve të vajzave, bie lehtësisht pre e tyre dhe kur kupton se qe mashtruar, është vonë.

Në këtë roman, figura e vajzës dhe tërësia e karakterit të saj është themeli mbi të cilin ngrihet fabula dhe merr udhë subjekti.

“Gjumi mbi borë” na shfaq momentet kur Dibra u formua si njeri dhe si shkrimtar, duke u kthyer nga ai kush ishte në atë kush është. Me tone herë-herë frojdiste, autori tregon se si kaloi vitet në një fshat të largët malor ku qe emëruar mësues letërsie. Gruaja që ka më afër është mësuesja e muzikës, ndërsa ajo që ndien më afër është e fejuara e tij, letrat e së cilës i konsideron më të rëndësishme se disa nga librat më të rëndësishëm botërorë.

Në romanin “Treni i muzgut”, grua shfaqet si gjysma, pa të cilën burri përjetësisht do të jetë i paplotë. Duket sikur shpjegohet konkretisht ideja e dikurshme e Platonit se Perëndia pati krijuar njeriun me katër duar, katër këmbë dhe dy koka e kur pa se ky po evoluonte aq shumë sa po i afrohej Atij, vendosi ta ndajë duke iu dhënë vetëm një thirrje: të gjenin njëri-tjetrin.

Gruaja dhe vajza te Dibra shfaqen kryesisht dominuese të fshehta të personazheve kryesorë të romanit, duke u kthyer vërtet në virgjërshave të përjetshme të cilat as pena e autorit nuk ia del t’i zhvirgjërojë!

RIDVAN DIBRA

*Dashuritë
e virgjërshës
Madalenë*



OnufriRoman

FRYMËZIME DJALOSHARE

Nga Hyjni Ceka



I

Kadarenë e kam shok prej vitesh...

Jemi pjekur, së pari, ndën shkallë të gjimnazit Asim Zeneli”, në Gjirokastrë. Isha emëruar mësues në Lunxhëri. Ismaili... po... gjimnazist, në vit të dytë...

Poeti i ardhshëm s'qe, atëherë, veç një syth që priste të shpërthente. Edhe pse adoleshent, kishte besim në vetvete. Kështu që në takim m'u soll i barabartë. Dhe merrni me mend... unë, 19-vjeçar, ai, 15 vjeç! Katër vjet diferencë!

Atë mot, dua të them për vitin shkollor 1951-1952, azdisi. Krijoi disa cikle poezish, që s'ishin punë djelmoshash. Ato vinin si pranverë e gjenialitetit artistik.

Erdha të kaloja pushimet në verë. Në Elbasan solla prej Gjirokastrë vargjet e Ismailit të vogël. I recitoja me nge... në sheshin e hotel “Parkut”, po ka qenë dhe ëmbëltorja e Ligor Mishtës.

Ndër figura, më pëlqente ai krahasimi i HËNËS, SI VETULL VASHE. Vjersha për “1 Majin” më luante mendsh. Le cikli për “Rrugën e Dritës”, një pleksje e 12-rrokëshit me 9-rrokësh, një ritëm melodioz që të bënte të kërceje. Ismaili ishte nën influencën e poezive ruse, sidomos të Isakovskit, mjeshtër i ritmikës.

- Po mjaft! - më thoshin shokët.

Duket se e teproja.

“

Jemi pjekur, së pari, ndën shkallë të gjimnazit Asim Zeneli”, në Gjirokastrë. Isha emëruar mësues në Lunxhëri. Ismaili... po... gjimnazist, në vit të dytë...

Poeti i ardhshëm s'qe, atëherë, veç një syth që priste të shpërthente. Edhe pse adoleshent, kishte besim në vetvete. Kështu që në takim m'u soll i barabartë. Dhe merrni me mend... unë, 19-vjeçar, ai, 15 vjeç!

Dhe profetizoja atëherë:

- Një gjeni ka lindur për Letërsinë Shqiptare!

Ç'kam shokë... m'i përmendnin edhe sot këto fjalë:

- Ore, po e di që paske pasur të drejtë?!

Frederik Dodbiba, i pari...

Po... dhe Jan Haxhijakovi, këto më thotë, sa herë që piqemi bashkë.

Pyeteni, në mos besoni!

2

Vitin tjetër shkollor ma gjetën vegjën. Mes dimri më nisën në Fushëbardhë. Një gropë e thellë, mes malesh.

Po atë ditë të vajtjes sime arrin dhe Sekretari i Dytë i Partisë. S'e di për çpunë?! Por m'u fut në klasë, të më inspektonte.

I ziu unë! U bëra copash t'i rrëfeja shokut Islam artin tim të mësimdhënies.

Sekretari ngjijt tryezës, ulur në stol. Unë, në këmbë, duke punuar. Se si ktheva kokën. Kishte gjetur fletoren time të poezive. Lexonte. Mua nuk m'u drodh qerpiku... as veshi më bëri tërr. Vjershat, që të tëra, i kisha me “partishmëri”...

Kur sosi ora, u çua në këmbë.

- Shkruan?! - më pyeti.

- Nga pak, - iu përgjigja... si fakir.

- Partia ka nevojë për njerëz të talentuar. Po e marr me vete fletoren, t'ua rrëfej shokëve.

E di si i tha ato fjalë?! Ngrehur e ngrehur. Fryrë si gjel. Sikur gjëmonte. Sikur i binte me grusht atij gjoksi...

Unë, gjithë falënderime. Ku kisha parë, i ziu, “kujdes të Nënës Parti”! Në Elbasan, jo njëherë!

Gjithë gëzim atë javë! Shokët që ma kishin në dorë “ymrin”, po shqyrtonin krijimtarinë time.

Dhe zbrita... në fund të javës... Dhe bëra shtatë orë rrugë. Erdha në Gjirokastrë. Në Qafë të Pazarit, bëri ballë Ismaili. Shend i madh! Lum që e poqa! S'desha të më largohej, se më kishte marrë malli.

E luta të më shoqëronte deri në “Shesh të Çerçizit”, ku ndodhej Komiteti i Partisë. Për fletore s'i bëra fjalë.

Priti poshtë. Unë u ngjita te shoku Islam. Partiaku rrëmoi nëpër sirtarë e... mezi e gjeti bllokun. Pastaj bëri zakonin. U ngref prapë para se të fliste:

- Shumë bukur! Poezi të shëndosha! Me partishmëri!

Kaq qe e gjitha. Unë s'kisha ç'bëja. Zbrita shkallët.

Ismailin e gjeta që priste.

Tek veja, më zhbiroi. Pikasi bllokun.

Rrëfeva edhe unë.

- Po pse, nga Islam Shehu prisje vlerësimin e vjershave tuaja?! Ç'është Islami? Çoban dhish është!

Ja, ç'është! Bllokun s'ta kanë parë shokët. Ti drejt... e te shoku Islam!

E kam dëgjuar gjithë habi atë protestë, ndaj e mbaj mend fjalë për fjalë.

Ismail Kadareja nuk kishte lindur veç artist... por dhe karakter i veçantë.

Që në moshë të rinisë së hershme s'i bënte përshtypje fuqia e pushtetarëve! Ishte i ndërgjegjësuar që zotëronte forcë talenti. Dhe energjia krijuese nuk pyet as për njëfarë prepotence. Këtë ndërgjegjësim kërkonte ta nguliste dhe ndër shokë.

Gjithë kjo bisedë u zhvillua në rrugë, diku mbi Qafë të Pazarit, ku niste një kënd i prerë mes sheshit të Sokakut të Avokatëve dhe Bibliotekës së Vjetër. Për tryezë na shërbeu një arkë bosh. Aty i mbështetëm blloqet. Së fundi, i këmbuem krijimet. Tek kthehesha për Fushëbardhë, mora me vete dorëshkrimin e *Frymëzimeve djaloshare*, atë kopje që pa dritë botimi, një vit më vonë, më 1954.

3

Autobiografinë e popullit në vargje nuk mbeti njeri pa e lexuar.

Të tërë e morën si vepër të moshës së pjekurisë. S'do mend... Mesazhet e sakta folkloristike aty të çojnë.

Të pakë janë ata që dinë për “adoleshencën” e Ismailit, sidomos ata që kanë njohur pasionin e tij ndaj këngës popullore.

Ai u mbrujt si “ashik” i folklorit.

Ka qenë ditë pranvere e vitit 1953, kur e gjej të vetmuar në stolat përballë Çerçizit. Me fletë në dorë. Jepte e merrte mbi një këngë të lashtë. Ka qenë ajo e “Luftës së Plevnës”. I kishte ngelur mendja te vargu: *Osman Pasha i kalave...*

Pa të keq, marr e i them:

- Figura të tilla gjen sa të duash në Letërsinë Gojore.

Sido të ishte, vija katër vjet më i madh. Kisha dëgjuar më shumë.

Hapi sytë nën gjyzlykë. Pastaj m'u hodh:

- Pa m'i thuaj!

S'deshi të besonte.

Ç'më erdhën ndër mend, ia deklamova. Ashtu, spontanisht.

Ngeli!

- Ma përsërit edhe një herë *Amanetin e labit*?

Iu binda:

*Mike, në të kam për mike,
Kur të vdes, të bëhesh qiqe,
Të më qash brigje më brigje
Dhe me lot, moj, dhe me ligje!*

Buçiti... sa mbarova unë...

- Ç'është *Amaneti* i Shevçenkos¹ para saj?!

Mori e shënoi pastaj. Në atë copëz letër që mbante. Dhe shastiste:

- Si, more, si?! Të bëhesh qiqe?! Të fluturosh! Breg më breg?! Të më qash me ligje?! Me poezi elegjiake, domethënë! Në hapësirë? Në përjetësi?! Hajde-hajde!

Përhumbi.

Kur u çua, shpërtheu edhe një herë:

- Ia hodhi labi Shevçenkos. Me siguri!

Kështu pat nisur ajo bisedë për folklorin mes meje e Kadaresë.

Po pse nuk e ftove një herë në fshat? - do të pyesni ju.

Ç'ta ftoja? Gjirokastra ishte vetë një rezervuar poetik, ku vinin e derdheshin rrjedha poezish nga të katër anët. Prej Labërie do, apo nga Lunxhi. Letërsia Gojore e tërë Jugut, aty mblidhej.

Zuri mirë pastaj... e rrëmonte. Nisnim t'i shoshitnim. Herë piqeshim në një mendje, herë jo.

Mua më pëlqente kënga për Damo Lengon. Atij jo.

*Lengo me këllëç në dorë,
Pse s'u vrave ndër sinorë?!*

Siç dukej, atë "punën e jukut" e dinte që ahernaj se, më vonë, e tori gjatë e gjerë te *Kronikë në gur*.

Vazhdoi gjatë ky bashkëbisedim dhe as që do të ishte ndërprerë ndonjëherë, po të mos na dilnin të tjera shtigje e tjera rrugë përpara.

Megjithatë, për aq sa ndenja nëpër fshatra të Gjirokastrës, Ismaili po i mirësjellë ndaj meje. E ku më piqte, harronte të përshëndeste.

- Ç'na solle? - thoshte.

I jepja dhe unë këngë, gjetur nëpër dasma.

*Pse s'u bëre diell, të ndrisje dynjanë,
Po u bëre hënë, më more vëllanë!*

Kjo ndodhte të dielave në Qafë të Pazarit, ku mblidhej njerëzia mizë lisi.

Ai konkludonte prerazi:

- E kemi pasur dhe ne Parnasin. Si grekët e lashtë. Me siguri. Ja gjurmët!

Dhe e lokalizonte diku, mes Labërisë.

Nën Çipin. Te Buronjat!

4

Adoleshenca e viganit të letrave shqipe u shërben grigjave të krijuesve që nisin rrugën e artit.

Pa shpirt demokratik, pa karakter të fortë, pa respekt ndaj traditës, vatha e letërsisë nuk të qas përbrenda. Kadareja i ri ka qenë i ndërgjegjshëm për gjithë këto.

Dihet që "Rrethi letrar" i gjimnazit "Asim Zeneli" përmbledhte në gjirin e tij mjaft të rinj të dhënë pas letërsisë. Po, ngelën pas... Kjo ndodhi se "të tjerët" mësuan të ecnin me "patericat e partisë". Kadareja u ngrit në këmbë natyrshëm, siç u ka ndodhur tërë gjenive.

Adoleshenca e Ismailit kaloi në mjerim ekonomik. Një rrogë "ftuesi gjyqi" mbante pesë frymë. Nëna, pa punë. Djaloshi fort mirë mund të shkruante "seri" tekstesh për këngë masash... skeçe e "mbërrokulla" estradash për t'i ndihur shtëpisë. S'bëri nga këto... Prishte dorën ashtu...

Talentit i vuri kimet që më të ri. I shërbeu atij gjithë përkushtim.

Një natë në shtëpinë e tij gjendeshim në një "odá". Mbas darke, rashë të flija. Po aty.

Ai, jo!

Me dritë ndezur, më dilte gjumi. Ismailin e shihja mbi libra. Përgatiti mësimet, kreu detyrat, përktheu nga rusishtja... duket se edhe krijoi.

Kur shoi dritën, agonte.

Me këtë regjim e vetëperfeksionoi talentin Kadareja. Dhe vinte "i holltë". I tretur e mjaft delikat. U dhimbsej njerëzve, tek e shihnin...

Dërmoi vërtet trupin, në të ri... Po ja, ngeli energjik, për tërë jetën.

Kur botoi vëllimin e parë, gëzoi Shqipëria e tërë. Qe gjimnazist atëherë.

Për habinë e të gjithëve, Gjirokastra s'i bëri nderime. Kjo ndodhte se djaloshi nuk ua krihte bishtin partiakëve.

Gjërat, më pas, u bënë fare të qarta.

Si mori "pjekurinë" Ismaili, ne mbanim frymën. Pritnim nga po i del bursa. Ata vajtën e ia nxorën në Institutin tonë Katërvjeçar, për Filologji.

U bindërua rob se kishte, atë vit, të drejta studimi sa të doje. Jepte sovjetiku me të dyja duart: në institutin "Gorki", në "Lomonosov". Atje dërgonin "të besueshmit": Fatmir Selitën e Elbasanit dhe gjithë sojin e tij.

Ku jeni ju, ore, që u çuat me "paterica partie"!

Ku je ti, or Kadare?!

Ja që e paskan pasur të drejtë të urtët, kur i thanë ato fjalë të qëlluara:

*S'bëhet me të thënë,
Duhet me të dhënë...*

Duhet të të jepet pra!

Kësaj sentence t'i shtojmë, detyrimisht, autoperfeksionimin që, fare qartë, na e tregoi adoleshenca e Ismail Kadaresë...

5

Dhe përmendin se i këndoi "partisë" Kadareja!

Pse nuk themi për Virgjilin që hyjnizoi Oktavianin?

Pse nuk zëmë me gojë Firdusiun për Librin e Shahëve?!

Gjenitë ashtu e kanë. Japin një... e marrin njëqind. Ndryshe nuk kishte si denoncohej obskuri Arianit Çorraj, apo shoku Raqi, te *Dimri i madh*.

Nuk dërmohej... e thërrmohej Diktatura e Kuqe, te *Koncerti në fund të dimrit...*



¹ *Amaneti* është fjala për vjershën *Amaneti* të poetit ukrainas, Taras Shevçenko.



RRËFIM MBI KRYQËZUESIN E SHPIRTIT
(studentëve guximtarë të Shqipërisë)

mbi muzgun kalëruar kaloi vitet
kukudh i dalë nga pellgje zie
në birterri i lindur në terr jetoi
(agun e ndaloj me dekret të partisë)
ku shkeli ai u dergj toka
netëve rrëmbente tinëzisht orët-nuse
të mbetura sogje mbi fatet e vendit
i rrethonte në togje me telaferra
zërin e tyre në kujë e kthente
derisa i këndonin veç emrit të tij
nga kështjella e lartë e bronzte sundonte syçelë
gjersa vdiq

pas tij
gajtanët e jetës mbi tokë u këputën
dy shqipe lëshuan klithma ngashënjimi
(dridhma u ndie gjer te Kau i Zi)
zhgurëzuan plëngje e krushq e dasmorë
përmendoret bashkë me mite i thërmoi gdhirja
dhe me kujdes vendosi nga një kokërr urti
ndër libra historie

KËRCËNIM

dikush do të më paguajë shtrenjtë
gjithë turpet e fajet e mia

dhembjen
ndrydhjen

jetën time
dikush do ta paguajë
Arratisja

thonë se njeriu nuk zgjedh arratinë
se ajo zgjedh njeriun

por unë protestoj:
kishim një relacion të ndërsjelltë

kishte diku një fije zgjedhje
midis Jetës e Vdekjes

dhe unë zgjodha vetë:
më lëndon nëse e harron këtë

ALARM

shikoj shpesh jetën time
me panik

vetja ime

avion që bie
drejt meje

FAJI I TË MBIJETUARIT

Është e çuditshme kjo.
S’pres dot një festë, a një gëzim,
pa më shkuar mendja tek ata që ranë.
Pse unë jam, e ata jo?

NDARJA

mëma e përcolli gjer te porta
plaku e kish marrë në grykë brenda
(paj s’e ndjek burri çunin gjer jashtë)
kurse nga dritarja e katit të dytë
ia bënë me dorë motrat:
-vëlla, kthehu prapë!
(Zahir Pajazitit, dëshmor 1997)

ANKTH

duhet duhet duhet
të marr
frymë
të marr
frymë
ikën edhe kjo
bëhet mirë
bëhet mirë
bëhet mirë

FUGË

Të vdekur, ju thërras.
Zdirgjuni partenoneve hije, lini kolonadat.
Shikoni: fishekzjarrë, banderola, fushqeta
që fëmijët flakin ndër këmbët e mëtonjësve.
Flamur. Nuk i njihni: e thirren në ju.
Bukuria e tyre plak gjithçka. Edhe vdekjen tuaj.

Të vdekur, shikoni.
Larminë e ndërtuar padhembshëm mbi humbjen tuaj.
Frena fishkëllues. Autobusë me vonesë
kronike. Thirrje të shitësve, patriarkë e matron
tek endin robët e shtëpisë. Tufa të korbave
endin namë të ligë mbi ta. Edhe mbi vdekjen tuaj.

Të vdekur, dëgjoni.
Dikush mundohet të bëjë muzikë me kitarë,
me lahutë, me lugë të drunjta. Tjerët duartrokasin.
Disa ndreqin shtëpinë tërë ditën me tulla e gjak.
Tjerë ua prishin natën. Nën gurët e shesheve harresa
rrjedh lehtë, si gjak i të rinjve. Edhe vdekja juaj.

Të vdekur, ndijeni.
Dorën e një gruaje tek dhel fëmijën. Një fshatar
tek kundron me dorën strehë mbi sy retë sterrë.
Një mjek
tek thotë, Merr frymë thellë. Nxirre frymën.
Herën tjetër do rifilluar gjithçka nga lart poshtë
duke nisur nga retë. Edhe vdekjen tuaj.

Shqiptar Oseku, lindur në Gjakovë, por prej 30 vitesh jeton në Suedi, është vlerësuar zbulim në poezi përmes një tipi origjinal të vargut, herë si poezi sociale, metafizike, e herë si reportazhe pikëllimi... Deri tani ka botuar tri përmbledhje, por është autor e bashkautor i pesë antologjive poetike përkthyer nga shqipja në suedisht dhe anasjelltas. Është botuar në Kosovë, te “Koha Ditore”, si dhe në revistën e Institutit Albanologjik

SHQIPTAR OSEKU
POEZITË E MËRGIMIT

MAJ

si t’i them një dyvjeçareje të sëmurë se
mamaja nuk do të vijë

qysh t’ia ftilloj realitetet e jetës
punën, faturat, rrogën, qiranë, strehën mbi kokë
dashurinë e thyer
divorcin

Aria e vogël qan me tinguj të hollë
si këlysh i rrahur

jashtë shkërryhet maji në ngjyra të sëmura

Nga përmbledhja “Requiem për një dashuri” (Shtëpia botuese PA, Prishtinë, 2014)

PARALAJMËRIM

në ëndërr gjithçka është e mundur
ke mendjen
jeta është shpesh një ëndërr e ligë

VËZHGIM

ëndrrat: mund të ndërtosh jetë prej lëndës së tyre
njeriu: ai që ndërton jetë prej ëndrrash

STRATIOT

zemra si luftëtar i krisur
refuzon urdhrat për tërheqje

lufton me hije

VEDAT KOKONA ME DISHEPUJT E VOLTERIT



Në Tiranën e viteve tridhjetë, që kishte një tridhjetë mijë banorë dhe jo pesëqind e ca mijë si sot, kur shkonih e nuk shkonin një katër karroca dhe ndonjë veturë në sheshin e bashkisë, kur dilnin vetëm dy gazeta të përditshme dhe një revistë në javë, kishte një librari, i zoti i së cilës ishte Mit'hat Frashëri, alias, Lumo Skendo, bir i Abdylit dhe nip i Samiut dhe i Naimit. Kur mendoj se sot, në Tiranën më gjysëm milion e ca banorë, të mijërave veturave që paradojnë në karuzelin e Sheshit Skënderbej, ku botohen me dhjetra gazeta e revista në ditë, madje edhe pornoje dhe se nuk ka një librari si ajo e Lumo Skendos më shumë se gjysëm shekulli më parë, më hipën një valë hidhërimi që s'di si ta përcaktoj.

Ishte një librari e bukur, vendit të së cilës s'i ka mbetur as gjurma më e vogël; jo vetëm e asaj të parës të viteve '33 por as asaj që ishte në Rrugën Mbretnore, pranë Bela Venecias që më vonë u quajt Rruga e Barrikadave, dhe që sot dhe asaj i ka humbur vula. Sipas traditës së vendit tonë çdo gjë e bukur priset dhe vendin e saj e zë e shëmtuara.

Që disa vjet më parë kisha dëgjuar emrin e Lumo Skendos, emrin e librit "Hi dhe shpuzë", që kishte botuar në fillimin e shekullit tonë, pastaj edhe nga babai që e kishte mik dhe që ishte pajtuar në revistën "Dituria" që botonte në Tiranë në vitet tridhjetë. Nuk e kisha parë kurrë në kafenetë Bela Venecia dhe Kursal të kryeqytetit, siç shihja qeveritarët dhe intelektualët e asaj kohe.

Lumo Skendon mund ta gjeje vetëm në Librarinë Lumo Skendo. Iu luta babait të më shpinte një ditë tek ai. Më shpuri. E gjetëm ulur përpara një tryeze të gjatë katërkëndëshe. Ajo që më ra në sy posa e pashë ishte jaka e ngrirë e kollarisur, me dy cepa të ngritura siç e mbanin ata të shekullit XIX, kapaku i kollarisur i mëngës së këmishës që dilte nga xhaketa e kostumit

krem shantung që binte menjëherë në sy nga pastërtia dhe pastaj ajo fytyrë që s'ishte si fytyra të tjera. Është e vërtetë se s'ka fytyrë të jetë si një tjetër, ashtu siç nuk ka edhe shenja gishtash që të jenë identike por, në përgjithësi, të gjitha fytyrat e njerëzve janë njësoj në vështrim të parë, të shpëlara, pa kolorit. Një fytyrë ndryshe nga të tjerat është ajo që godet menjëherë vështrimin si një rreze dielli. Ajo që më bëri përshtypje në fytyrën e thatë ishte shkëlqimi i syve. Thashë se ky njeri ishte ndryshe nga ata që kisha njohur deri atëhere, me përjashtim, sigurisht, të babait tim.

Ai sikur u gëzua - apo ashtu m'u duk mua, - kur mësoi se studioja në Liceun e Korçës. Që atë ditë, sa kohë isha në Tiranë gjatë, kohës së pushimeve të verës, do veja shpesh në Librarinë e tij. Një ditë, iu luta t'i bëja vizitë në shtëpi, se kisha dëgjuar që kishte një bibliotekë shumë të pasur. Më ftoi më gjithë zemër. Vajta.

Më duket sikur e kam para syve edhe sot e kësaj ditë pas gjashtëdhjet vjetëve. Ishte një nga ato shtëpitë e vjetra tiranase, me dy kate me oborr të madh, në rrugën e Tennis Klubit. Kati i parë ku qëndruam, përbëhej nga një salloni i madh muret e të cilit ishin mbuluar me libra. U ulëm në dy karrige të vjetra përpara një tryeze të vogël vezake, ku ishin vendosur një filxhan kafeje me pjatë dhe një cigarishte. E dija që s'e pinte duhanin dhe ajo cigarishtja më tërhoqi vëmendjen.

-Po shikon cigarishten?

-Si urdhëron, i thashë me një zë pak të druajtur. Ju s'e pini duhanin?

-Kjo cigarishte dhe ky filxhan kafeje janë të Naimit.

M'u duk sikur isha në ëndërr. Kisha përpara meje cigarishten dhe filxhanin e kafesë të Naimit dhe, pranë meje, ja, këtu, nipin e Naimit, Mit'hat Frashërit! A kishte gjë më të bukur. Më bëri çaj, solli edhe kutinë e vogël me peta sheqeri.

-Sa peta?

-Tre.

-Jo, bir, çaji puhet me pak sheqer. Një petë e ke mjaft.

I kundërshtohesh Lumo Skendos? Kisha dëgjuar se ashtu e pinin dhe anglezët. Jo me një petë, po edhe pa sheqer fare e pija me ëndje atë çaj nga dora e tij!

-Mit'hat bej, pse nuk shkruani një monografi më të gjatë se ajo që keni shkruar për Naimin, sepse përveç jush, s'ka se kush ta shkruaj?

Mirë i thashë, më duket? Ç'mirë zeza! Se mos kishte nevojë ai për mendimin tim. Nuk më dha përgjigje. E kuptova që kisha nderur jashtë jorganit këmbët që m'u bënë akull: kisha lëshuar një notë të rreme në simfoninë e asaj pasdrekeje të bukur. I fola me admirim për librin e tij "Hi dhe shpuzë", për ato copa proze poetike që më pëlqenin aq shumë, për tregimin "Si vdiq Selman Todorusha", që i kisha lexuar që në moshën 14 vjeçare, për revistën "Dituria" që i vinte babait, me atë lëndë aq të pasur që, të them të drejtën, ishte pak e rëndë për stomakun tim, thesar i vërtetë kulturës sonë. Sikur u vrenjt pak, më hodhi një vështrim ku shprehej si një farë keqardhjeje për atë djalë të ri dhe tha: "Do t'ia kuptosh më vonë vlerën e vërtetë". Kishte shumë të drejtë. Si shumë gjërave, vonë, tepër vonë, ua kam çmuar vlerën, sepse gjatë jetës sime zhurma e dauleve dhe zurnave më ka penguar të dëgjoj fyellin magjik të artit. Një ditë e pyeta për shkrimtarët francezë, cili i pëlqente më shumë? Tjetër pyetje pa vend, për të mos thënë idiote. Se mos janë dy a tre që të zgjedhësh si ata dy a tre shkrimtarë që kemi ne?

U tregua i duruar më mua edhe i sjellshëm. Ishte shumë ironi, dishepull i Volterit dhe i Anatol Fransit dhe mund të më ngulte një thumb që ta mbaja mend tërë jetën.

-Anatol Fransi.

Nga ai kam edhe sot admirimin tim për autorin që më njohur me Silvestër Bonarin, që e kam lexuar më se dhjetë herë.

Një ditë, më fali një libër që i kishte pëlqyer shumë, "Un jardin sur l'Orient" (një kopësht në Orontë) të Moris Baresit, për të cilin më foli me pasion sidomos për prozën e magjishme. Iu zotova se, meqë i kishte pëlqyer, do ta përktheja. Më vështroi me një buzëqeshje të lehtë stërpikur me ironi: "Në arrifsh dot"! sikur donte të thoshte ajo buzëqeshje. Isha duke shkruar asi kohe disa poezi lirike dhe, me guximin e të riut, iu luta të më shkruante një parathënie. Prisja dhe isha i sigurt se do të merrja një përgjigje mohuese. Si u mendua pak, më tha:

-Kur e do?

M'u duk sikur isha bërë me fletë!

-Kur të doni ju, Mit'hat bej!

Kaloi java dhe parathënien e kisha në dorë. Në dorë! Përmbledhja e parë e vjershave të mia "Dritë dhe hije" me parathënien e Lumo Skendos! Mrekulli! Fluturova te Luarasi! Me këtë kaniks po nisesha për në dasmën e letërsisë...

Fragment nga libri me kujtime, botimet "Kokona"



Lumo Skëndo në librarinë e tij

Komentar/ Patetika e lartë, në mënyrën e vet, një trimërim i zëshëm i të gjithë fragmentit përgjatë 76 vargjeve, kumbon me po atë tendosje në një radhë poezish të afërta në frymë të Akhmatovës, sidomos në këtë që po publikojmë këtu. Kjo bën diferencën e poetëve, të cilët ne kemi arsye t'i quajmë "të mëdhenj", në raport me të tjerët

ANNA AKHMATOVA FATI PERSONAL DHE QYTETAR I POETES... EDHE NË PËRTEJVARR

Nga Agron Tufa



Poezia qëndron në shtratin e temës, së skicuar më së qarti në poezinë e vitit 1922 "Të shumtëve". (Shih gjithashtu: "Por unë po ju paralajmëroj", 1940; "Ashtu siç jam. Paç fat me një tjetër", 1942; "Kujt dhe kur i kam thënë", 1952; "Përnën cilat rrënoja po flas", 1959.) Megjithëse "ju", këtu kuptohet si rrethi i bashkëkohësve (lexuesve apo njerëzve në përgjithësi, të cilët në një mënyrë a në një tjetër u përfshinë në rrethanat e jetës së autores), të ndarë nga poetja, megjithëse jo krejt shpërfillës ndaj fatit të saj. Aspak "llumra", po më saktë, janë ata të cilët mund t'i quash ende të ndjeshëm, përvujtnarë, solidarë, simpatizues, por që asnjëri nuk ka kurajën ta bashkëshoqërojë

poeten në rrugën e saj, të hedhë hapin e fundit të bashkimit me të ("Vërtet do ta pini gotën që unë pi dhe do të pagëzoheni me atë pagëzim me të cilin unë pagëzohem. Por të vë ndokënd të më rrijë në të djathtën ose në të majtën time – kjo nuk është në pushtetin tim ta jap – kjo gjë u përket atyre për të cilët është bërë gati"... Ungjilli sipas Markut, X, 39-40, sipas përkthimit të Dom Simon Filipajt, "Drita", Ferizaj, 1994).

Përpos kësaj, në poezi vihen re motivet danteske që janë karakteristike për të në periudhën e kalimit të saj nga faza e hershme e interpretimit në të vonën, pra përqendrimi në fatin personal dhe qytetar të poetes, i cili do ta ndjekë atë dhe në botën

e përtëjvarrit. Kthimi kah Dantja e ka bashkëshoqëruar krijimtarinë e Akhmatovës, si rregull, me temën e syrgjynit/dëbimit dhe shënjohej me metafora të tilla: "këmisha e pendimit", "qiriri" dhe "buka e hidhur", që përsëritet në shumë poezi të saj, duke nisur nga "Nuk jam unë nga ata që braktisin vendin" (1922) e duke mbaruar me "Trashëgimtares" (1959). Mirëpo, nga fillimi i viteve '60 dominues bëhet "vendi i rrathëve danteskë" (kryesisht në "Prologun" dhe në "Rradhinjtë e mesnatës"). Kjo poezi shënon qasjen e parë të saj te periudha danteske: "në satërin e zi" (krahaso me vargjet e vitit 1935 "Përse ju i helmuat ujërat": "...Pa një xhelat e një staër/ nuk mund të ketë poet mbi dhe./ Me një këmishë pendimi veshur,/ me një qiri – ec e l'sho kujë"), sikundërse dhe vargjet e kësaj poezie: "Duke u sjellë në hon të zi,/ Në mort të mbramë, a në parajsë."

Ndoshta shenjë më bindëse e shfaqjes së ngjashmërisë në këto poezi të Akhmatovës, – që i shëmbëlajnë frymës danteske

– është patosi i përgjithshëm i tonit, më shumë sesa ballafaqimi skrupuloz me citate. Kryqëzimi citator dhe përshkrimor ndërmjet vargjeve e poezive është aq i shpeshtë, sa këtë gjë e kanë vërejtur me kohë akhmatologët. Por, me sa di unë, në rrethin e përkimeve tekstuale që sjellin rëndom deri më sot nuk janë ndeshur vargjet "Pse pra, ju, lirinë e mbrame/ Po e shndërroni në një shpellë?" – nga poezia që përmendëm "Përse ju e helmuat ujërat". Shpellë (Bepren) – "strehë e cubave, kriminelëve dhe përdhosësve" sipas fjalorit bashkëkohor – do të thotë edhe bordello, në të cilën po shndërrohej gjithë Rusia sovjetë, në analogji me kujën demaskuese të Dantes për Italinë ("Purgatori", vargjet VI, 78).

Patetika e lartë, në mënyrën e vet, një trimërim i zëshëm i të gjithë fragmentit përgjatë 76 vargjeve, kumbon me po atë tendosje në një radhë poezish të afërta në frymë të Akhmatovës, sidomos në këtë që po publikojmë këtu. Kjo bën diferencën e poetëve, të cilët ne kemi arsye t'i quajmë "të mëdhenj", në raport me të tjerët.

ANNA AKHMATOVA (1889-1966)

Të çmendur! As vetë s'e di,
Nuk e di se ku po shkoj –
Duke u sjellë në hon të zi,
Në mort të mbramë, a në parajsë
Po ju tërheq me vete pas.
Vaj, se ç'krenari mizore
Na lidhi si armik symprehtë,
Më ngjeth kjo qëndresë që prore
Në besë betimesh digjet vetë.
Se ku ju shpura pa e ditur,
Mezi do t'ju bjerë në hatër –
Në cilin vend jeni gostitur,
Si në një qilar t'murosur
Në orë të ligë me kokë në satër.
Papo se ç'turp me mua ndatë
Me heshtjen time vitesh strukur...
Do të rroni, jeni... ishit, patë...
Ndërsa unë – ylli i këputur.

Moskë, 10 tetor 1959 (ditën)





NATA E VARRIT DHE NJERIU POLITIK

Nga Nebi Bardhoshi*

Shoqëria tradicionale, frymëzuar nga besime të krijuara apo pranuar me ngenë e saj, krijoi institucionet e së vërtetës. Dikush, ende sa pa vdekur, linte në këtë jetë “të fundit fjalë”.

Njerëzit tradicionalë të asaj kohe kishin ndjesinë e vazhdueshme se po vdisnin. Kjo ndjesi duket sikur nuk ka mbërritur dhe aq sot. Por me gjasë diçka rri ndër ne, si shprehi e të jetuarit në mes të dy botëve. Ata apo këta që na qeverisin, ose kryetarët e partive kryesore, e ndiejnë se këto janë ditët e tyre të fundit. Vuajtja e tyre është e thellë, sepse institucionet e së vërtetës në institucionet bashkëkohore nuk kanë të njëjtin funksion. Për rrjedhojë, nuk shkaktojnë as të njëjtin kuptim për “rëfimin” e as për “amanetin”.

Nëse njeriu me pushtet sot dëshmon të vërtetën për borxhet e pashlyera në këtë jetë, ajo çka e pret është burgu. Në të shumtën do të ishte burgu në përjetësi. Nuk do të kishte ndëshkime me vdekje, sepse dënimi me vdekje është hequr... Njeriu tradicional duhej të dëshmonte të vërtetën për borxhet e pashlyera, sepse shpirti i tij/ saj do të ngelte mes dy botëve ose në asnjërën botë

plotësisht. Më kanë thënë që nëse i vdekuri nuk i rrëfen pengjet e shpirtit pa vdekur, goja i mbetet e hapur, po ashtu edhe sytë. Prandaj i duheshin shtrënguar nofullat me forcë e t'i lidheshin, përndryshe goja nuk i mbyllej. Oh, për sytë e hapur s'kishte zgjidhje! Sytë dëshmojnë më shumë se çdo gjë tjetër pengjet e poezitë e kësaj bote.

Njeriu politik me shumë pushtet ndër ne, i mban gojën dhe sytë hapur nga frika dhe lakmia.

Më kanë thënë se njerëzit dikur (aty-këtu edhe sot) besojnë te Nata e Varrit. Disa e quajnë thjesht si ditë gjykimi për çfarë kanë bërë në jetë... Kurse njeriu në politikën tonë e njeh mundësinë e gjykimit vetëm përpara të fortit e më të fortit se ky i fundit. Pra, njeh ligjin e më të fortit! Prandaj ai gjithë kohën mendon se si të jetë edhe më i fortë, por s'ka asnjëherë, asnjë shtysë se si të jetë më i drejtë. Njeriu tradicional kujdeset t'i lajë borxhet pa vdekur: kjo e bën të pranueshëm për botën ku beson se do të shkojë, por edhe shpreson se nuk do t'i shahet shpirti në botën që lënë pas. Prandaj njeriu politik në ditët tona kërkon dhe ia del të shembë çdo formë lidhjeje me tjetrin, veç lidhjes dhe nënshtrimit prej të fortit e përdorimit e nënçmimit të të dobët.

E kur ju vjen dita e vdekjes politike, ata rendin të bëhen më të fortë, ose të gjejnë strehë tek të fortët. Të vërtetën s'e dëshmojnë dot!

*Antropolog

SHPJEGIMI E CENON THELBIN

Mos u shpjegoni aspak në qoftë se doni të kuptoheni. (Diderot)

Nga Edison Çeraj

Ndoshta arsyeja kryesore se pse mundohemi kaq dendur për t'i dhënë shpjegim çdo gjëje është se duam t'i “zotërojmë”, të kemi “pushtet” mbi to dhe kështu të ndihemi më të “sigurt”. Por, sa herë që e kemi bërë, jemi privuar nga thelbi i gjësë, ose e kemi cenuar atë. Jo të gjitha gjërat janë të një rendi, apo të një natyre. Domethënë, ka gjëra që nuk mund të shpjegohen, që janë jashtë domenit të njohjes njerëzore. Kjo është ajo ana tjetër e dijes, ana “mëkatore”, kur ajo u heq aurën (breroren) gjërave, duke na ofruar një botë pa hije, të zhveshur nga aromat, ku njeriu ndihet përherë e më i huaj dhe pikërisht në këtë gjendje tëhuajësuese nis edhe zhveshja – shtresë pas shtrese – nga individualiteti. Fjala vjen, për ta bërë më të përfutueshëm subjektin, tjetër gjë është Ungjilli dhe Jezui, tjetër është Kisha dhe Shën Pali në historinë e krishterimit. Me Kishën dhe Shën Palin, krishterimi bëhet historik, duke ngritur institucionin, teologjinë, dogmën si dije; nis klasifikimi i Frymës, përcaktimi i saj. Të njëjtin fenomen ndeshim edhe në rastin e artit, në veçanti me kritikën si dije, e cila ka prirjen e vazhdueshme të na thotë se çfarë kuptimi ka një vepër e caktuar, çfarë është bërë “mirë” në të e çfarë jo siç “duhet”, deri dhe recetën se çfarë duhet bërë në të ardhmen. Qoftë dhe në rastin kur autori i vë një titull veprës, në njëfarë mënyre është bërë shpjegimi, si një syth drejt dijes mbi artistiken. Për aq kohë sa dikush nuk ia di titullin një veprë arti, është krejt i lirë të “fantazojë” shumë e shumë gjëra mbi atë vepër, duke nxjerrë kështu një “përfundim” të cilin e ndan (mbi të gjitha) me veten, si një ritual katarsisi ose si një shteg për të pasuruar vetëdijen. Ama, në çastin që

lexon titullin, nuk mund të jetë edhe aq i lirë, sepse deshi apo nuk deshi, çdo gjë që do t'i provokojë vepra, do të jetë i detyruar ta kalojë nga filtri i titullit. Për rrjedhojë, “mesazhi” i veprës vjen duke u ngushtuar. Pa folur pastaj për tekstin shoqëruar të një veprë, që në shumë raste të kujton manualët e përdorimit të objekteve elektro-shtëpiake, duke diktuar kështu një marrëdhënie tërësisht racionale mes publikut dhe veprës së artit. Një prej karakteristikave të kësaj kohe është se jemi të rrethuar nga manualët e përdorimit, pothuajse për çdo gjë, qoftë *online*, qoftë të shtypur. Aq shumë janë shtuar këta manualë, saqë edhe për një gjë/ çështje të vetme mund të gjesh me dhjetëra syresh. Fillimisht imponohen me delikatesë, si “udhërrëfyes praktik”, më pas skematizojnë marrëdhënien tonë me sendet/ gjërat dhe si rrjedhojë, edhe me botën. Puna arrin deri aty sa kemi edhe manualë “turistikë” se si të sillemi kur shkojmë në Afrikë, Kinë, Rusi, në vendet arabe e kështu me radhë, me arsyetimin për të shmangur “keqkuptimet”, duke harruar se keqkuptimet janë pjesë e natyrës sonë, nga të cilat



kemi trashëguar shumë gjëra të mrekullueshme, si, fjala vjen, veprat e Shakespeare-it, ku keqkuptimi luan një rol qendror.¹

Me pak fjalë, sipas kësaj logjike asgjë nuk duhet t'i lihet rastit, së papriturës, çdo gjë duhet parashikuar. Manualët na ndihmojnë që të mos jemi të papërgatitur.

Të njohësh kufijtë e tu dhe të ndalosh tek ai cak të cilin nuk mund ta tejkalosh, është dije, madje një dije thelbësore, sepse ndan dy zona: atë që mund të njohim dhe atë që nuk mund të njohim, atë që mund të jetë dije dhe atë që nuk mund të jetë. Në njëfarë kuptimi, e gjithë filozofia është përpjekje për çështjen se çfarë mund të njohim, kurse teologjia² është përpjekje për atë që nuk mund të njohim. Por, ato ndërkëmben me njëra-tjetrën dhe kjo tregon se që të dyja janë dije, domethënë kërkim për pushtet. Pushteti në këtë rast nuk nënkupton atë që njihet përgjithësisht sot, pavarësisht se prej këtij pushteti derivon edhe pushteti në kuptimin e ngushtë politiko-ekonomik. Pra, shpjegimi/ interpretimi është dije dhe dija është pushteti i pushteteve, më misteriozi syresh. Çdo pushteti tjetër veç dijes, si fillim i duhet të jetë fjalë, ligjërim, pra dije, duke hedhur kështu farën për legjitimitetin e tij, për nevojën që kanë njerëzit për të, dhe më pas thjesht i duhet të përshtatet në varësi të kontekstit.

Sa më shumë t'i shpjegojmë gjërat, aq më shumë zvogëlohet hapësira e lirisë.

¹ Ndër të tjera, keqkuptimi është një gjendje e pavullnetshme për të shmangur atë që nuk të duhet, siç ndodh me imunitetin, i cili na mbron pa vullnetin tonë në çastin që në trup shfaqet një anomali e caktuar.

² “Pushteti” i krishterimit nuk nis me kishën si qendër, por me teologjinë, që ngrii dogmën.

KINEMATOGRAFI



Filmi shqiptar “Delegacioni” fiton çmim në Trieste Film Festival 2019

Delegacioni, me skenar të Artan Minarolli e me regji të Bujar Alimani është shpallur fitues në kategorinë “Best Feature Film” në Trieste Film Festival 2019. “Tetor 1990, regjimi komunist në Shqipëri po përpiket të mbajë pushtetin. Një delegacion europian vjen në Tiranë për të monitoruar zbatimin e reformave të qeverisë – një parakusht i madh që Shqipëria të pranohej në OSBE. Leo është marrë fshehurazi nga një burg i largët dhe është sjellë në kryeqytet. Ai ka qenë një i burgosur politik për 15 vjet. Tani ai është bërë jashtëzakonisht i vlefshëm për qeverinë. Delegacioni europian udhëhiqet nga një shok i shkollës së vjetër të Leo-s. Detyra e tij është të kontrollojë progresin e të drejtave të njeriut në Shqipëri. Leo mund ta bindë atë se gjithçka është në rregull. Por asgjë nuk shkon siç është planifikuar”.

Ky film është bashkëprodhim në mes të Shqipërisë (Art Film shpk), Kosovës (Bleri Production), Francës (Zorba production) dhe Greqisë (Graal Films). Në film luajnë aktorët: Viktor Zhusti, Xhevdet Ferri, Ndrim Xhepa, Richard Sammel, Kasem Hoxha, ndërsa nga Kosova në film paraqiten aktorët Bislim Muçaj, Selaman Lokaj, Avdullah Gjokaj, Fatlume Bunjaku, Armend Ismajli, Gani Morina, Artan Selimi, Imer Loshi.

OSCAR 2019 “Roma” dhe “E preferuara” kryesojnë nominimet

Roma dhe *E preferuara* janë në krye të garës së çmimeve “Oscar 2019”. Filmat e Alfonso Cuaron rreth qytetit të Meksikës në vitet ’70 (që më herët ka fituar çmimin “Leone d’oro” në Vencia) dhe i Yorgos Lanthimos rreth oborrit të mbretëreshës Ana të Anglisë janë përzgjedhur në 10 kategori, bënë me dije gjatë ditës së djeshme aktorët Kumail Nanjiani dhe Tracee Ellis Ross. Pasojnë filmi *Vice* i Adam McKay dhe *A star is born* i Bradley Cooper, me 8 nominime secili. Ndërsa *Black Panther* është nominuar në 7 kategori, filmi i parë me superheronj që kandidon si filmi më i mirë në historinë e Academy Award. Të pestë filmat e mësipërm garojnë edhe në kategorinë më të lakmuar si filmi më i mirë, ku do t’u duhet të përballen me *Green Book* të Peter Farrelly, *BlacKkKlansman* të Spike Lee dhe *Bohemian Rhapsody*, filmin biografik të Freddy Mercury nën regjinë e Bryan Singer. Në garën për statujën e aktorit më të mirë protagonist, sfidohen mes tyre Bradley Cooper (*A star is born*), i preferuari Christian Bale (*Vice*), Viggo Mortensen (*Green Book*), Willem Defoe (*At Eternity’s Gate*) dhe Rami Malek (*Bohemian Rhapsody*). Ndërsa aktoret në garë për “Oscar” në kategorinë e protagonistes më të mirë janë Glenn Close (që sapo ka shpënë në shtëpi çmimin “Golden Globe” për *The Wife*), Olivia Colman (*The favourite*), Yalitza Aparicio (*Roma*), Lady Gaga (*A star is born*) dhe Melissa McCarthy (Çifti origjinal).

Mikaela Minga, muzikologe në Institutin e Antropologjisë Kulturore dhe Studimeve të Artit, ndërsa zbulon hollësi rreth historisë si u ngjiz albumi muzikor “Këngë arumune të Drenovës”. Një album me këngë folklorike, përgatitur nga Mikaela dhe i ati, studiuesi dhe muzikologu Josif Minga, i publikuar nga shtëpia diskografike me qendër në Itali “Squilibri Editore”.

MIKAELA MINGA, CD-ja UNIKE ME KËNGË ARUMUNE, JETA NOMADE E BREZIT TË FUNDIT

Nga Suadela Balliu

Mikaela Minga, muzikologe në Institutin e Antropologjisë Kulturore dhe Studimeve të Artit, ndërsa zbulon hollësi rreth historisë si u ngjiz albumi muzikor *Këngë arumune të Drenovës*. Një album me këngë folklorike, përgatitur nga Mikaela dhe i ati, studiuesi dhe muzikologu Josif Minga, i publikuar nga shtëpia diskografike me qendër në Itali *Squilibri Editore*. Publikimi, rrëfen më tej Mikaela Minga, është rezultat i një kërkimi thuajse trevjeçar me këtë komunitet dhe paraqet, të dokumentuar, repertorin e interpretuar nga brezi i vjetër i këngëtarëve vllahë. “Nisi në fillim të 2016-ës”, - kujton Minga. - “Im atë më tha: ‘Është një grup vllah në Drenovë. Më kanë kërkuar vazhdimisht të shkoj t’i dëgjoj, pse nuk vjen edhe ti?’ Kështu shkuam.” Ajo thotë se i ati, Josif Minga, dy prej këngëtarëve, Spiro Gramozin dhe Aleks Mihallarin, i njihte prej vitesh. “Me t’i dëgjuar, bëra disa regjistrime të vogla dhe ajo që më bëri përshtypje, ishte cilësia shumë e mirë e zërit të secilit dhe mënyra se si funksionin së bashku.” Ajo që ia shtonte edhe më kërkimin, ishte fakti se bëhej fjalë për një pjesë të trashëgimisë kulturore të një komuniteti, si ai arumun, apo i njohur ndryshe edhe si vllahët e Shqipërisë. Albumi, me këngët e përzgjedhura nga vetë ky grup këngëtarësh e muzikantësh të komunitetit vllah, të ruajtura me shkrim dore në një fletore e të kënduara brez pas brezi, do të realizohej në Drenovë, në verën e 2017-ës. “Nuk bëme ndryshime të mëdha; ishin këngët që kërkonin ata të regjistronin, duke shtuar një melodi instrumentale, Vallen e Kapedan Ilias”, - kujton Minga. Kompakt disku mban pesëmbëdhjetë këngë në arumanisht, një në gjuhën shqipe, titulluar *Në këtë dynja* dhe një instrumentale, që është Vallja e Kapedan Ilias. “*Në këtë dynja* e këndojnë në shqip”, - do të sqaronte Josif Minga gjatë përrurimit të albumit muzikor. Ka edhe këngë të tjera që i këndojnë në shqip, thotë ai, por gjithmonë duke ruajtur identitetin e tyre. “Në këtë dynja, ç’jemi?” - thonë. - “Do të na mbulojnë me baltë, do të na mbulojnë me dhe...” Sipas profesor Mingës, të dyja kulturat, ajo arumune dhe ajo shqiptare, kanë dhënë e kanë marrë me njëra-tjetrën.

Në këtë repertor të përzgjedhur dëgjohen zërat e gjashtë këngëtarëve: Aleks Mihallari, Spiro Gramozi, Spiro Bello, Thanas Tona, Jorgo Malelli

dhe Agim Hysenllari, protagonistë të të kënduarit në tri pjesë vokale, me tre role, ku i pari dhe i dyti bazohen te solisti dhe e treta është isoja, që ka një rol funksional shumë të rëndësishëm në përcjelljen e fizionomisë së këngës.

“Polifonia toske ka një karakteristikë, që ndahet në tre role: marrësi, pritësi dhe isoja. Janë melodi të kufizuara në shtrirjen e tyre, por mënyrat e ndërhyrjes janë aq të ndryshme, sa të habisin ndonjëherë”, - vijon Minga, ndërsa zbërthen hollësi teknike të të kënduarit.

“Ka momente ku zëri kryesor bie dhe shfaqet zëri i dytë. Ka momente kur japin e marrin në formën e një dialogu apo ku zëra të caktuar krijojnë efekte timbrike, duke i përdredhur zanoret”. Sipas saj, larmia brenda këngëve është e pasur.

Vasil Tole do të sqaronte më herët edhe vështirësitë e regjistrimit të polifonisë toske. “Polifonia toske, polifoni shumëvëlleshë; secili nga zërat ecën në një linjë të caktuar. Ndërsa labja është ndryshe, silabike – i gjithë grupi këndon dhe i rrahin rrokjet dhe është më kollaj për të regjistruar polifoninë labe, sepse vijnë perkusionet, zhurmat e natyrës, ashtu në fakt edhe shijohet. Por kur bëhet një CD si kjo duhet pasur parasysh polifonia toske, isoja solide dhe pastërtia e zërit”. Sipas Toles, kjo polifoni ngjan me ison e gajdes dhe unisonin e këndimit bizantin. Kërkon njerëz të përgatitur për të mbajtur në kohë të gjata nivele pedali që të bëjnë të mundur shkrirjen brenda shumëzërëshit të madh. “Në brendësi të repertorit të propozuar në këtë kompakt disk dallohen dy lloje këngësh; disa ndjekin metrikën e vargut të kënduar, të tjera referojnë qeliza ritmike, të rregullta. Këto të fundit bëjnë pjesë të vallja e kënduar. Në këtë tipologji këngësh dallojnë këngëtarët Thanas Tona dhe Spiro Bello, veçanërisht te kënga *Mi Sculai dit tabini, Ni*





pitricu dada cu oili, Na-atseli sti-abatâ dhe Napârti di-amari. Tekstet e gjashtëmbëdhjetë këngëve rrëfejnë histori të thjeshta të jetës së të shkuarës, por edhe probleme bashkëkohëse, përmbajtjet kapërcejnë një sërë zhanresh tekstuale: nga lirikja tek tragjikja, nga alegorikja te humoristikja. Në këtë kuptim rezultojnë shumë interesante dy këngët mbi emigrimin, *Americâ laiâ* dhe *Tÿi mi lo doru*, ku marrësi ose solisti i parë, që është Spiro Gramozi, ekzekuton një regjistër të spikatur të sferës akute. Një tjetër material është *Di când deadi laia lunâ*, që në shqip do të përkthehej *Hënë moj e zeza hënë*, që paraprihet nga një introduktë e ngadaltë instrumentale, metrikisht e lirë, për klarinetë, violinë, llautë dhe tambur, kur Aleks Mihallari, më i moshuari mes këngëtarëve, i ditëlindjes 1935, performon edhe pjesën e dytë. Ai ia merr dhe ia pret këngës”, - shpjegon Josif Minga kompozitor, kërkues shkencor si edhe drejtor artistik i grupeve muzikore.

Katër instrumentet, të luajtura nga Telando në klarinetë dhe Eraldo Feto violinë, Agron Murati llautë dhe Agron Nasi në dajre, hyjnë në skenë te vallja, instrumentalja *Djocul al capedan Iliâ*, Vallja e Kapedan Ilias. Albumi fikson kështu një fenomen muzikor me vlerë të madhe, me zëra unikë që do të mbetet si trashëgimi e vlerave kulturore të këtij komuniteti.

Pasi albumi u regjistrua, pritej përgjigjja e publikimit nga *Squilibri*, me të cilët Mikaela Minga kishte pasur përvoja të mëhershme me botimin e librit *Spanja Pipa dhe kënga urbane e Korçës*, në vitin 2015. Mikaela Minga, duke i studiuar nga afër këngët e tyre, thotë se kanë tekste për emigrimin, jetën nomade, ngjarjet në komunitet. “Nuk hapen te fenomene apo ngjarje historike. Janë të mbledhura në jetën nomade dhe me personazhet e komunitetit të tyre”. Ka një këngë tjetër, krijuar në nder të Vasil Trashës, pilotit vllah që humbi jetën në aksident. Ishte homazh që donin t’i bënin atij dhe ishte një nga të afërmit e një prej këngëtarëve. Kanë gjithashtu këngë për fenomenin e gjakmarrjes. “Pas viteve ’90, - shpjegon Minga, - komuniteti arumun do të kalonte një tjetër përplasje kulturore, si ajo e viteve ’50, kur shteti i bëri të integroheshin në shoqërinë shqiptare, por duke sakrifikuar shprehjen me gjuhën e tyre. E megjithatë, në mjediset intime, festa e gëzime, e praktikonin. Pas viteve ’90, ndodhi polarizimi dhe politizimi. Emigrimi i largoi nga qendrat e tyre dhe sot kemi brezin e fundit. Në biseda flitej shqetësimi për të ardhmen, brezat që rriten nuk e këndonin këtë këngë. Ky regjistrim është një lloj dokumentimi, Aleks Mihallari, është mbi 80 vjeç...” Spiro Gramozin dhe Aleks Mihallarin, pas 25 vitesh emigrim në Greqi, i bëri bashkë dëshira për të kënduar si edhe për të rrëfyer jo vetëm


historinë e trashëguar, por edhe atë të jetuar. “Në kohën kur Spiro Gramozi, iniciator për këtë projekt, kthehet në Shqipëri, fëmijët e tij emigrojnë në Angli dhe këtë ndarje dhe mall e mbështeti me këngë”, - zbulon Minga, duke shtuar se është edhe ndër të parapëlqyerat e saj kjo këngë.

Minga rrëfen më tej se, ndërsa albumi ishte në fazën e post-produksionit, shteti shqiptar e njohu komunitetin arumun si pakicë kombëtare, pasi për 18 vite ishin njohur si pakicë kulturore. “Dhe kjo tregon shumë”, - shton studiuesja. Për anëtarin e Akademisë së Shkencave, Vasil Tole, vlera më e madhe e këtij kompakt disku është dokumentimi i vlerave muzikore polifonike të arumunëve të Shqipërisë. “Kjo trashëgimi ka qenë pjesë e trashëgimisë muzikore e popullit shqiptar, ka dhënë e ka marrë me të dhe jo më kot këto këngë ekzistojnë në të dyja gjuhët, sa në gjuhën e mëmës, por edhe në vendin ku u mirëpritën dhe si të tilla kanë qarkulluar në repertorin muzikor të popullit shqiptar, kur i dëgjon dhe i krahason”. Kompakt disku muzikor është një tribut edhe për ata që nuk kanë mundur ta përcjellin zërin për më tej. “I bën nder atij komuniteti dhe Pavllo Shollës, mjeshtrit arumun, që ka bërë për muzikën popullore shqiptare sa asnjë nga ne nuk ka bërë”, - do ta cilësonte Vasil Tole, duke e parë këtë CD, si një fillesë për një nismë që institucionet e shtetit shqiptar mund të ndërmarrin për të dokumentuar trashëgiminë e minoriteteve. “Një shoqëri do të jetë e kulturuar dhe e zhvilluar nëse bën për kulturën e minoriteve, po aq sa bën për të vetën. Dokumentimi dhe popullarizimi mes këtyre formave vetëm na fisnikëron”. Edhe Josif Minga është i mendimit se ky album i bën nder polifonisë toske. “Po shijoja profilin real të këtyre këngëtarëve, shprehur nga forca e karakterit. Siç piktura kthen kohën në hapësirë, muzika kthen hapësirën në kohë. Mbi të gjitha, po t’i mendojmë këta personazhe atje në ajrin e pastër, kur fryn era dhe blegërijnë kafshët, ka një kuptim me të vërtetë magjik”. Minga thotë se do të dëshironte ta vijonte edhe më tej këtë projekt. “Më pëlqen që punën të përpiqem ta përhap, të mos rrijë brenda asaj strukturës së ngushtë shkencore, dhe kjo është arsyeja pse synoj drejt këtyre formateve”. Por nuk i fsheh vështirësitë në realizim. “Më duhet të falënderoj tim atë, i cili ishte thelbësor në mënyrën si hyra; një femër studiuese, mes gjithë burrave. Nuk do ta kisha pasur të lehtë pa ndërmjetësinë e tij, është mirë të ketë më shumë publikime muzikore, është e rëndësishme, qofshin online, CD, LP, nuk ka rëndësi”, - thotë Minga, duke prekur fenomenin e YouTube, që i largon njerëzit gjithnjë e më shumë nga një objekt i prekshëm, siç do të ishte një kompakt disk, në këtë rast. (Gazeta Si)

LIBRA TË RINJ

Koleksioni “Magazina e komunizmit shqiptar”

Albumi *Magazina e komunizmit shqiptar* është përgatitur nga Elektra Çapaliku, si fryt i një pune të gjatë kërkimore në terren dhe në nivele të tjera, si: biblioteka, internet e media sociale, për grumbullimin, sistemimin dhe interpretimin e objekteve që kanë shoqëruar jetën e




njeriut shqiptar në periudhën e komunizmit. Sjellë nga shtëpia botuese “Graphic Line”, kemi të bëjmë me një koleksion me rreth 500 imazhe të përzgjedhura dhe të grupuara në kapituj, si: Triska e tullona; Mobilitet; Elektroshpërndarje; Pajisje ngrohjeje dhe gatimi; Ndriçues; Telefona, aparate fotografike dhe orë; Enë kuzhine; Kafe e takëme kafeje; Cigare dhe takëme duhani; Ujë dhe lëngje të tjera; Ushqime; Pije alkoolike; Veshje; Shtresa dhe mbulesa; Lavanteri; Lojëra; Artikuj shkollorë; Pajisje zyre; Bicikleta e motoçikleta; Lekë si dhe objekte të tjera të ndryshme. Në libër, përveç objekteve të paraqitura, gjenden edhe një numër aktesh të botuara në gazetatat zyrtare, foto private si dhe faksimile dokumentesh. Libri na vjen si një arkiv pamor, një katalog i koleksioneve të dyqaneve socialiste, duke pasur si qëllim të ofrojë një histori alternative të komunizmit shqiptar, nëpërmjet kulturës pamore të objekteve të përditshmërisë, historisë së penetrimit të projektit komunist në jetën private e urbane dhe përpjekjes për një unifikim total të shijes së shqiptarëve.

BIBLIOTEKA FILOZOFIKE Freud me dy ese në shqip

Ka dalë në librari *E ardhmja e një iluzioni; Ligështimi në qytetërim*, dy ese nga Sigmund Freud, përkthyer nga Sokol Kosta, botimet “Pika pa sipërfaqe”. Eseja e parë përbën një nga shqyrtimet më të hollësishme të Freud-it mbi temën e fesë. Autori analizon lindjen, zhvillimin dhe përsiatet mbi të

ardhmen e fesë si fenomen individual dhe shoqëror. Në esenë e dytë, Freud analizon konceptin e “qytetërimit/kulturës”, funksionet që ai kryen në frenimin dhe rregullimin e instinkteve të individit dhe “ligështimin” që rezultojnë nga kjo marrëdhënie. Të shkruara relativisht vonë në karrierën e gjatë të themeluesit të psikanalizës, pas tronditjes që pësoi Perëndimi – dhe autori – nga lufta e përgjakshme e viteve ’14-’18 (L. I Botërore), esetë paraqesin një ndër tablotë më pesimiste të natyrës njerëzore dhe të qytetërimit sipas konceptimit freudian dhe shënojnë një pikë kthese të mëtejshme në mendimin e tij. Veçanërisht eseja e dytë është një nga tekstet më të rëndësishme e më të studiuara të Freud-it.



Janë vitet '70, një grua dyzetvjeçare shkruan në një atmosferë rurale romanin e saj më të suksesshëm, duke kujtuar mundimet e fëmijërisë, jetën e vështirë kur sapo krijohej një realitet i ri në historinë e vendosjes së emigrantëve... Kjo është Moragë Gan, heroina e romanit, cilësuar kryevepra e shkrimtares kanadeze Margaret Laurence. Bëhet fjalë për romanin "Falltarët", sjellë në shqip nga botimet OMBRA GVG, me përkthimin e Eliona Balilajt

MARGARET LAURENCE

PORTRETET E PAHARRUESHME TË GRAVE KUNDËR DEMONËVE TË TYRE

Janë vitet '70, një grua dyzetvjeçare shkruan në një atmosferë rurale romanin e saj më të suksesshëm, duke kujtuar mundimet e fëmijërisë, jetën e vështirë kur sapo krijohej një realitet i ri në historinë e vendosjes së emigrantëve... Kjo është Moragë Gan, heroina e romanit, cilësuar kryevepra e shkrimtares kanadeze Margaret Laurence. Por kritika e ka krahasuar si një vepër gjysmë autobiografike, me shumë nota të përbashkëta me vetë shkrimtaren.

Bëhet fjalë për romanin *Falltarët*, sjellë në shqip nga botimet OMBRA GVG, me përkthimin e Eliona Balilajt. E lindur në Neepawa, Mantoba, Margaret Laurence është konsideruar si një nga zërat

më të fuqishëm në letërsisë kanadeze. Kur Laurence shpërthen, kujtojmë se letërsia kanadeze, si në anglisht dhe frëngjisht, mori zhvillim të jashtëzakonshëm pas Luftës së Dytë Botërore. Që atëherë, me trashëgiminë e saj të dyfishtë kulturore, ajo reflektoi fazat e tregimit e identitetit kombëtar. Fiction kanadeze, si edhe forma të tjera krijuese, lulëzoi sidomos nga fundi i viteve '60 dhe '70. Por kjo letërsi u konsolidua dhe mori famë me kontributin e fortë të shkrimtareve gra si Margaret Laurence, Alice Munro dhe Margaret Atwood. Në mesin e romanciereve kanadeze, Laurence zë një pozicion unik. Për të kanë shkruar se ajo, ndoshta, i kupton gratë më mirë sesa burrat dhe ka disa frymëzime që arrin t'i marrë vetëm nëpërmjet grave. Ndërsa shqyrton në gjithë krijimtarinë e saj shqetësimet mbi identitetin dhe përpjekjet për të zbuluar në mënyrë imagjinare dhe për t'u marrë me problemet e grave. Pra, romanet e saj zakonisht janë të orientuara për nga identiteti i gruas/kombit, si dhe statusin e tyre në shoqëri për t'u zhvilluar dhe ngritur profilin e saj në kërkime të veçanta për të mbërritur në identitetin kanadez.

Mbi këtë motiv shkruhet seria e katër librave bazuar në qytetin e saj, shtëpinë, të riuqajtur Manawa, për të cilat ajo tani është e njohur: *The Stone Angel* (1964), *A Jest of God* (1966), i rititulluar *Now I Lay Me Down*, për publikun anglez, *The Fire Dwellers* (1969), dhe *The Diviners* (1974).

Kritika është ndalur të theksojë se çdo roman i Laurence mund të përshkruhet, në një mënyrë apo tjetër, si "autobiografi imagjinare" duke dhënë portrete të paharrueshme të grave që mundohen t'ia dalin me demonët e tyre personale, që përpiqen përmes vetekzaminimit

për të gjetur modele kuptimplota në jetën e tyre. Protagonistët e saj, në fillim të romaneve, mund të jenë viktimë, por në fund ato refuzojnë të bëhen të tilla – gjendja e tyre e shkretëtirës i shndërron ato, duke krijuar kështu një udhëtim aktual, metaforë për udhëtimin drejt historisë së kombit kanadez dhe pranimin e trashëgimisë së tij.

Në një intervistë të vitit 1979, Laurence përshkruan se si rrënjët e saj ndikuan në gjithë krijimtarinë.

"Unë mendoj se prapavija e së shkuarës sime ka përcaktuar fatin e të shkruarit tek unë nisur nga vendi ku kam lindur. Tani e shoh shumë të vështirë për ta përcaktuar këtë. Mendoj se kjo vjen nga një mënyrë krejtësisht e pavetëdijshme ose e nën-ndërgjegjshme ime. Kështu mund të shpjegohen shprehjet, idiomat në të cilën unë shkruaj, si dhe mënyrën se si flasin njerëzit duke marrë shumë nga vendlindja".


Romani *Falltarët* i shkrimtares së mirënjohur Margaret Laurence konsiderohet si një ndër romanet klasike të letërsisë kanadeze. Ai është romani i fundit i Laurence dhe është botuar në vitin 1974.

Romani fitoi çmimin Governor General Award në vitin 1974.

Falltarët ka pasur një realizim kinematografik në vitin 1993 dhe u transmetua në televizionin CBC. Heroina e romanit *Falltarët* quhet Moragë Gan dhe është një romanciere e suksesshme dyzeteshtatëvjeçare dhe një nënë e vetme cila jeton në një fermë në Ontarion rurale, ku po përpiqet të shkruajë një roman të ri. Zbulimi i disa fotografive të çastit kur ka qenë fëmijë i sjellin në jetë një sërë kujtimesh të cilat alternohen me ngjarjet në të tashmen e saj.

Moraga e ngelur jetime në moshë fare të njomë rritet në qytetin e vogël të Manauakas nga babai i saj adoptiv Kristi Logan, i cili ishte pastruesi i plehrave të qytetit, dhe gruaja e tij e shëndoshë dhe e sëmure, Prina. Sigurisht, ata nuk ishin familja e saj ideale, por ama nuk ia kursyen dashurinë dhe respektin në formën dhe mënyrën që ata dinin. Përgjatë romanit shpalosen përpjekjet e Moragës për të kuptuar dhe pranuar identitetin e saj dhe luftën e saj për të ruajtur pavarësinë e vet si dhe për të gjetur vendin e saj në botë.

Romani, në gjerësinë e vizionit të tij dhe thellësinë e angazhimeve socio-kulturore, konsiderohet gjerësisht si kryevepra e Laurence dhe një nga romanet më të mëdha kanadeze të shkruara ndonjëherë. Madje shpeshherë është krahasuar si një vepër gjysmë autobiografike me shumë nota të përbashkëta me vetë shkrimtaren.



Falltarët paraqet një portret madhështor, postmodern, vetërefleksiv të jetës kanadeze në disa breza, raca dhe klasa. Romani kthehet prapa në kohë dhe i rikthehet përsëri realitetit bashkëkohor të viteve '70, pas në historinë e vendosjes së emigrantëve dhe zhvendosjen e njëpasnjëshme të popujve të parë dhe të metisëve ose ndryshe atyre me gjak të përzier, dhe në një të ardhme të imagjinuar me dimensione ekologjikisht të tmerrshme, por shpirtërisht shpresëdhënëse.

Falltarët synon të nxjerrë një rrugë shpresëdhënëse në një të ardhme më të lumtur nga padrejtësitë dhe pabarazitë e dëshpëruara të së kaluarës së përbashkët koloniale. Gjithashtu është një himn i lirisë së individit duke i qëndruar besnik e krenari identitetit dhe rrënjëve të thella, pavarësisht kohës, vendit apo rrethanave.

Ky është një tregim i fuqishëm i një gruaje të pavarur që refuzon të braktisë kërkimin e saj për dashuri. Për Moragë Gan rritja në një qytet të vogël kanadez është një proces i ashpër – vendosja e distancës mes vetes dhe një botë që nuk donte pjesë të saj. Por me kalimin e kohës, vetmia që dikur ishte mikja e saj më e mirë, bëhet një e drejtë e çmuar – e lënë vetëm në nevojën e saj të madhe për dashuri. Përsëri Moraga është e detyruar të provojë forcën e saj kundër botës – dhe më në fund arrin jetën që ajo kishte vendosur se do të ishte e saj.

Te Moragë Gan, Laurence ka krijuar një figurë, eksperiencia e së cilës rezulton si e të gjithë njerëzve të privuar në kërkim të së drejtës së parëbirtisë dhe të një njeriu që mbijeton si një simbol frymëzues i guximit dhe i qëndrueshmërisë.

Falltarët rrëfen një histori preke, por realiste, ku personazhet e saj të paharrueshëm nuk bëjnë gjithmonë atë që pret lexuesi, por sillen ashtu si në jetën e vërtetë, atë që njohim të gjithë.

Në vitet 1970 romani krijoi një polemikë në Ontario për përkrahjen e amësisë së vetme në figurën e Moragës, e cila e lë martesën e saj të qëndrueshme me një profesor anglez të Torontos për t'u bërë shkrimtare dhe vendos të rrisë e vetme një fëmijë jashtë martese në rrethana të pasigurta ekonomike. Disa kritikë zbulojnë një ankth të fshehtë më të fuqishëm në polemikën mbi portretin pozitiv të një lidhjeje mes Moragës, e cila kishte prejardhje skoceze, dhe këngëtarit metis, me racë të përzier Xhuls Toner. Sigurisht, shkrimtarja ishte më tepër realiste nga sa prisnin kritikët, por gjithashtu shfaq një të vërtetë të pathënë, por që pas pak dekadash do të bëhej realiteti që njohim dhe shohim çdo ditë.

Marrëdhënia interracial mes Moragës dhe Xhulsit, herë pas here e dalldisur, shpesh e largët, por gjithnjë e thellë, bëhet simbolike, në vizionin krijues të Margaret Laurence-it për situatën ndërkulturore të shpërnguljes kanadeze, ku të gjithë jemi jetimë dhe të adoptuar, si Moraga dhe të gjithë janë bërë "Metisë", si Xhulsi dhe vajza e tyre Pikeja: nëse jo me gjak, atëherë me trashëgiminë e përbashkët të shpërnguljes ndërkulturore, duke na ofruar mundësi unike bashkëkohore të dashurisë dhe paqes në të gjithë kufijtë tradicionalë dhe ndërkombëtarë.

Falltarët është vlerësuar nga shumë kritikë si arritje e jashtëzakonshme e karrierës së shkrimtares Margaret Laurence. Temat që përshkruajnë librin janë universale. Si dhe pse i marrim vendimet që marrim dhe cilat mund të jenë rezultatet ose pasojat? "Romani i Margaret Laurence është poetik dhe i strukturuar, dhe heroina e tij sigurisht që është një nga gratë më njerëzore, më të pahyjnizuara, jopolemike dhe më të besueshme që është shfaqur në fiction kohëve të fundit", - shkruan *The New Yorker*. Ndërsa Library Journal, ndër të tjera, veçon: "Fuqia e vërtetë e Laurence qëndron në aftësinë për të ringjallur me përpikëri atë emocion kaq të njohur, tmerrin e jetimes, guximin e krisur të adoleshentes, zemërimin dhe urrejtjen për veten, dobësinë e të moshuarve, brishtësinë e të mposhturve. *Falltarët* është një tjetër vepër, pjesë e veprave klasike të rrënjësura thellë në traditën e romanit."



Margaret Laurence është një ndër figurat kryesore të letërsisë kanadeze. Laurence ishte një ndër themeluesit e *Writer's Trust* të Kanadasë, një organizatë jofitimprurëse letrare që kishte si synim të inkurajonte komunitetin e shkrimtarëve të Kanadasë.

Margaret Laurence ka lindur në Neepawa, Manitoba, në vitin 1926. Pas diplomimit në United College të Winnipeg-ut në vitin 1947, ajo punoi si gazetare për gazetën e qytetit *Winnipeg Citizen*.

Nga viti 1950 deri në vitin 1957 Laurence ka jetuar në Afrikë, dy vitet e para në Somali dhe pesë vite të tjera në Ganë, ku punonte bashkëshorti i saj i cili ishte inxhinier civil. Gjatë qëndrimit të saj atje ajo përkthente poezi dhe proza somaliane, dhe kështu filloi karrierën e saj si shkrimtare me tregime të shkurtra, ngjarjet e të cilave zhvilloheshin në Afrikë.

Kur Laurence u kthye në Kanada në vitin 1957, ajo u vendos në Vankuver, ku u përkushtua shkrimit: në romanin e saj të parë, *This Side Jordan*, dhe në koleksionin e saj të parë me proza të shkurtra, *The Tomorrow-Tamer*. Dy vitet e saj në Somali u bënë

subjekt i shënimeve biografike, *Prophet's Camel Bell*. Pas ndarjes nga bashkëshorti në 1962, Laurence u shpërngul në Angli, e cila u bë shtëpia e saj për një dekadë.

Laurence u vendos në Lakefield, Ontario, në vitin 1974. Margaret Laurence është nderuar me shumë çmime dhe shumë tituj nderi, ndër to është vlerësuar dy herë me çmimin prestigjioz kanadez Governor General's Award. Në zemrat e kanadezëve të një moshe të caktuar, Margaret Laurence ka një vend të veçantë si romancierja e parë e madhe e vendit të tyre që ata kanë lexuar ndonjëherë. Pas disa muajve të përballimit me kancerin e mushkërive, Laurence ndërroi jetë më 5 janar 1987, në moshën 60-vjeçare, kur para se të vdiste, ajo u pyet për trashëgiminë e saj.

"Njerëzit ndonjëherë më thonë: sa kohë mendoni se vepra juaj do të jetojë? Nuk kam ide më të vogël dhe kjo është më e pakta e shqetësimeve të mia", - i tha ajo një gazetari më 1986. - "Sigurisht, shpresoj që disa libra të vazhdojnë të shiten derisa unë të largohem nga kjo luginë e lotëve".

Ndërsa librat e saj vazhdojnë të shiten në shumë gjuhë.

1500 lekë

“Lexohet si *Iliada* ... pjesërisht kujtime udhëtimesh, pjesërisht rrëfim epik.”
—*Washington Post*

GENGHIS KHAN



dhe krijimi i
BOTËS MODERNE

JACK WEATHERFORD

Minerva